

20222363435

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË ENERGETIKËS (\*)

#### Neni 1

Në Ligjin e Energetikës (\*) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 96/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriut, numër 96/19) në nenin 1 pika 3) ndryshohet dhe bëhet:

„statusi dhe kompetenca e Komisionit Rregullator të Energetikës, Shërbimeve të Ujit dhe Shërbimeve për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut;“.

#### Neni 2

Në nenin 3, pika 9) ndryshohet dhe bëhet:

„ „prodhues virtual” “ është prodhuesi ose furnizuesii cili është pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike dhe i cili në mënyrë komerciale dhe teknike integron prodhues të energjisë elektrike, konsumatorë-prodhues dhe operatorë të magazinave për energji elektrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, me çka mundësohet menaxhim i centralizuar i prodhimitarisë së tyre dhe trajtimin e tyre si një prodhues që merr pjesë në tregun e energjisë elektrike“;

Në pikën 38) fjalët: „dhe biomasë“ në fund të fjalisë fshihen.

Në pikën 46) fjalët: „të grupit të balancimit“ fshihen.

Pika 62) ndryshohet dhe bëhet:

„Sistemi për shpërndarjen e gazit natyror” është rrjeti i gazsjellësve me presion të ulët dhe presion të mesëm, pajisje dhe stabilimente tjera, si dhe rezervë operative me presion maksimal të punës deri në 16 bar;”.

Në pikën 72), në fund të fjalisë, pas fjalës “shërbime” shtohen fjalët „si dhe për përcaktimin e elementeve për përlllogaritjen e çmimeve të shitjes për energji elektrike nga furnizuesi universal dhe furnizues në rast përfundimtar dhe për çmimin e shitjes për gaz natyror nga furnizuesi me gaz natyror me detyrim për shërbim publik“;

Në pikën 81) shtohen 13 pika të reja 82), 83), 84), 85), 86), 87), 88), 89), 90), 91), 92), 93) dhe 94) siç vijon:

„82) „operatori tregut të energjisë elektrike” është shoqëria që e organizon dhe menaxhon tregun e energjisë elektrike dhe është përgjegjëse funksionimin dhe zhvillimin efikas të tij;

„83) „operatori tregut të gazit natyror” është shoqëria që e organizon dhe menaxhon tregun e gazit natyror dhe është përgjegjëse funksionimin dhe zhvillimin efikas të tij;

„84) „prodhues i energjisë elektrike” është personi i cili ushtron veprimtari energjetike prodhim të energjisë elektrike dhe është i regjistruar në regjistrin tregtar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe person tjetër juridik që është i regjistruar në regjistrin e personave të tjerë juridikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe prodhon energji elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë,

85) „magazinin i energjisë elektrike” është prolongimi i përdorimit përfundimtar të energjisë elektrike deri në momentin e radhës pas momentit kur është prodhuar, respektivisht shndërrimin

---

\* Me këtë ligj bëhet harmonizim me Rregullativën 1227/2011 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të BE-së për integritetin dhe transparencën e tregjeve të energjisë me shumicë (CELEX 32011R1227) nga 25.10.2011, Rregullativën 347/2013 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të BE-së mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike trans-europiane (CELEX 32013R0347) nga 17.04.2013 dhe Rregullativën 2015/1222 të Komisionit Europian për krijimin e udhërrëfyesit për ndarjen e kapaciteteve dhe menaxhimin e ngulfatjeve (CELEX 32015R1222) nga 24.7.2015.

e energjisë elektrike në lloj tjetër të energjisë e cila magazinohet në magazinë për energji elektrike të lidhur me rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike dhe rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për shkak të shndërrimit të sërishëm të mëvonshëm të saj në energji elektrike dhe shfrytëzim;

86) „operatori magazinës për energji elektrike” është personi që ushtron veprimtari energjetike magazinim të energjisë së prodhuar ose furnizuar elektrike në magazinë për energji elektrike;

87) „sajber siguri“ është aftësia e rrjetit dhe sistemeve informative që janë pjesë përbërëse e sistemit të transmetim dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të sistemeve për menaxhimin e objekteve për prodhimin e energjisë elektrike për t’u mbrojtur, në nivel të përkufizuar të sigurisë, nga sulmet dhe incidentet që cenojnë besueshmërinë, integritetin, autenticitetin dhe qasjen e të dhënave të përpunuara në këto sisteme ose të shërbimeve të ndërlydhura që sigurohen ose deri te të cilat arrihet nëpërmjet këtyre rrjeteve dhe sistemeve.

88) „informacion i brendshëm“ është informacioni i saktë që nuk është shpallur publikisht dhe është i lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me një ose më shumë produkte energjetike në tregjet me shumicë dhe që, nëse publikohet, do të ndikonte në çmimet e atyre produkteve energjetike, me çka për qëllimet e këtij përkufizimi, informacion paraqet:

- Informacion që duhet të publikohet në përputhje me këtë ligj dhe rregullat dhe aktet tjera të miratuara dhe aprovuara në përputhje me këtë ligj, ose

- Informacion i lidhur me kapacitetet dhe shfrytëzimin e objekteve për prodhimin, magazinimin, konsumin ose transmetimin e energjisë elektrike ose gazit natyror, duke përfshirë mospasjen e planifikuar ose të paplanifikuar të këtyre objekteve, ose

- Informacion që duhet të jetë i arritshëm publikisht në përputhje me detyrimet e përcaktuar në këtë ligj dhe rregullat dhe aktet tjera të miratuara dhe aprovuara në përputhje me këtë ligj, marrëveshjet ose praktikatat e zakonshme të tregut përkatës të energjisë me shumicë, nëse mund të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi çmimet e produkteve energjetike në tregun me shumicë; ose

- Informacione të tjera që pjesëmarrësit në treg do t’i kishin shfrytëzuar si bazë për vendime për tregtim dhe lëshim të fleturdhëresës për tregtim të produkteve energjetike në tregjet me shumicë;

89) “Informacion i saktë” është informacioni që udhëzon në përmbledhjen e rrethanave ose ngjarjeve që ekzistojnë ose pritet të shfaqen ose ndodhin dhe është mjaft i detajuar në mënyrë që të mundësojë miratimin e konkluzionit për ndikimin e atyre mundësive ose ngjarjeve në çmimet e shitjes me shumicë të produkteve energjetike;

90) „produkt energjetik në tregun me shumicë“ është marrëveshje ose derivativ, pa marrë parasysh vendin ose mënyrën e tregtimit, për furnizimin ose transmetimin e energjisë elektrike ose gazit natyror ku realizimi ose transmetimit bëhet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose në territorin e palës kontraktuese ose pjesëmarrëse në Marrëveshjen për Bashkësi Energjetike, me çka marrëveshjet për furnizim dhe shpërndarje të energjisë elektrike ose gazit natyror për konsumatorët përfundimtar nuk konsiderohen për produkte energjetike në tregjet me shumicë, përveç marrëveshjeve për furnizimin e konsumatorëve përfundimtar me kapacitet të konsumit të barabartë ose më të madh se konsumi i përcaktuar me këtë ligj;

91) „tregu i energjisë me shumicë“ është çdo treg në të cilin pala kontraktuese ose pjesëmarrëse në Marrëveshjen për bashkësi energjetike tregtohen produkte energjetike në tregun me shumicë;

92) „me shkrim“ ose „në formë të shkruar“ është çdo shënim që përbëhet prej fjalëve dhe numrave që mund të lexohen, shumëzohen dhe të njoftohen në mënyrë plotësuese, duke përfshirë edhe dokument elektronik përmbajtja e të cilit është magazinuar në formë elektronike dhe transmetohet me mjete elektronike, e sidomos shënime tekstuale ose zanore, vizuale ose audiovizuale;

93) „PECI (Project of Energy Community Interest)“ është projekt me interes për bashkësinë energjetike, i aprovuar me vendim të Këshillit Ministror të Bashkësisë Energjetike,

94) „PMI (Project of Mutual Interest)“ është projekt i interesit të përbashkët, i aprovuar me rekomandim të Këshillit Ministror të Bashkësisë Energjetike“.

#### Neni 3

Në nenin 4, paragrafi (1), në pikën 20), pika në fund të fjalisë zëvendësohet me pikë dhe presje.

Pas pikës 20) shtohet pikë e re 21) siç vijon:

„21) magazinim i energjisë elektrike“.

Në paragrafin (2) fjalët: „Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe Shërbimeve Ujore të Republikës së Maqedonisë“ zëvendësohen me fjalët: „Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale të Republikës së Maqedonisë Veriut“.

#### Neni 4

Në nenin 8, në paragrafin (1), pas pikës 7) shtohet pikë e re 8) siç vijon:

„8) miratimi dhe ndjekja e zbatimit të masave dhe aktiviteteve për sigurimin e sajber sigurisë së rrjetit dhe sistemeve informatike që janë pjesë përbërëse e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe të sistemeve për menaxhimin e objekteve për prodhimin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, strategjia kombëtare për sajber siguri dhe plani i veprimit i strategjisë kombëtare për sajber siguri dhe rregulla të tjera që parashikojnë masa dhe aktivitete për sigurimin e sajber sigurisë.“.

Pikat 8) dhe 9) bëhen pika 9) dhe 10).

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

“(4) Në kushte të ekzistimit të përcaktuar të gjendjes së krizës në fushën e energjetikës me qëllim që të garantojë siguri në furnizim, mund të merren masa për furnizim me energji elektrike për konsumatorët që kryejnë veprimtari me interes publik si dhe për konsumatorët tjerë, vetëm nëse si masa janë përcaktuar me urdhëresën nga neni 14 paragrafi (1) i këtij ligji.“.

#### Neni 5

Në nenin 11, në paragrafin (3), pas fjalëve: „pesë vite“ shtohet presjedhe fjalët: „e nëse Qeveria vlerëson se është e nevojshme mund edhe më shpesh, me procedurën e rregulluar me paragrafin (1) të këtij neni“.

#### Neni 6

Neni 15 ndryshohet dhe bëhet:

”(1) Qeveria, me propozim të Ministrisë, e pas mendimit paraprak nga ministria kompetente për çështjet nga fusha e mbrojtjes sociale dhe Komisioni Rregullator i Energjetikës, miratoi urdhëresë për mbrojtjen e konsumatorëve të rrezikuar të energjisë me të cilën veçanërisht rregullohet:

1) konsumatorët të cilët bëjnë pjesë në kategorinë e konsumatorëve të rrezikuar,

2) masat që duhet të ndërmerren për mbrojtjen e konsumatorëve të rrezikuar të energjisë, duke përfshirë subvencione për konsumin e energjisë të dedikuara për amvisëritë që nuk janë parashikuar me programin për subvencionimin e konsumit të energjisë në përputhje me rregullat për mbrojtje sociale,

3) masat që duhet të ndërmerren për kursimin e energjisë dhe përmirësimin e efikasitetit energjetik,

4) mënyra e zbatimit të masave dhe organeve kompetente përgjegjëse për zbatimin e tyre,

5) masat që duhet t'i ndërmarrin operatorët e sistemeve për shpërndarje të energjisë dhe

6) masat që duhet t'i ndërmerr furnizuesi me detyrim për sigurimin e shërbimit publik, respektivisht shërbim universal në furnizimin me energji.

(2) Qeveria, deri në fund të vitit rrjedhës, me propozim të ministrisë dhe ministrisë kompetente për çështjet nga fusha e mbrojtjes sociale, e pas mendimit paraprak nga Komisioni Rregullator i Energjetikës, miraton Program për mbrojtjen e konsumatorëve të rrezikuar të energjisë për vitin e radhës me të cilin zbatohen masat e përcaktuara me urdhëresën, sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe mjetet dhe burimet e nevojshme për financimin e zbatimit të tyre.

(3) Masat nga urdhëresa sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk guxojnë të prishin konkurrencën dhe të pengojnë funksionimin efikas të tregjeve të energjisë elektrike, gazit natyror dhe energjisë termike dhe nuk guxojnë të sjellin deri te subvencionimi i kryqëzuar i kategorive të caktuara të konsumatorëve.

(4) Qeveria në çdo dy vjet e njofton Sekretariatën e Bashkësisë Energjetike për zbatimin e masave nga urdhëresa, sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(5) Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut mbron të drejtat dhe interesat e konsumatorëve të energjisë elektrike, gazit natyror dhe energjisë termike në mënyrën dhe në procedurën e përcaktuar me ligj”.

#### Neni 7

Në nenin 24, paragrafi (1), në pikën 1), pas nënpikës 6, shtohet nënpika e re 7 siç vijon:

„- rregullat për vendosjen dhe zbatimin e masave të detyrueshme teknike dhe organizative për sigurimin e sajber sigurisë së objekteve për prodhim dhe sistemeve për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë, si dhe për shkëmbimin e informacioneve dhe njoftimeve për kërcënimet dhe incidentet që e cenojnë sajber sigurinë“.

Në nënpikën 18, pas presjes shtohen fjalët: “si dhe vendime për heqjen ose ndërprerjen e vendimit për shfrytëzimin e tarifës preferenciale për energji elektrike”.

Në nënpikën 21, pas presjes shtohen fjalët: “si dhe zgjidhjet për ndërprerjen e këtyre zgjidhjeve”.

Nënpika 22 ndryshohet dhe bëhet:

„- rregullat për procedurë, kushte, kritere dhe metodologji për vlerësimin e institucioneve dhe rreziqet në PECI dhe PMI dhe për publikimin e indikatorëve dhe vlerave përkatëse referente për krahasimin e shpenzimeve investuese“.

Pas nënpikës 22 shtohen tri nënpika të reja 23, 24 dhe 25 siç vijon:

„- rregulla për përjashtim nga zbatimi i detyrimeve të caktuara nga rregullat e rrjetit për transmetimin e energjisë elektrike,

- aktvendime për përjashtim nga zbatimi i detyrimeve të caktuara nga rregullat e rrjetit për transmetimin e energjisë elektrike,

- vendim i gjykatave, mënyra dhe afatet për harmonizimin e shfrytëzuesve aktualë të sistemit për transmetimin e energjisë elektrike me rregullat e rrjetit për transmetimin e energjisë elektrike“.

Në pikën 2), pas nënpikës 5 shtohen tri nënpika të reja 6, 7 dhe 8, siç vijon:

„- rregulla për kushtet dhe procedura për përlllogaritje të koordinuar të kapaciteteve, si dhe metodologjitë e ndërlidhura me përlllogaritjen e koordinuar, ndërsa pas harmonizimit të tyre të realizuara në kuadër të trupave ndërkombëtare në të cilat merr pjesë operatori i sistemit për transmetimin e energjisë elektrike,

- modelet e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale të tregjeve një ditë më para dhe në ditë rrjedhëse, duke përfshirë edhe metodologjitë që rezultojnë nga marrëveshjet,

- listatarifore e kompensimeve për lëshimin, bartjen dhe njohjen e garancisë për origjinë nga operatori i tregut të energjisë elektrike“.

Në nënpikën 10, pas fjalës „shpërndarje“ shtohen fjalët „dhe transmetim“.

#### Neni 8

Në nenin 25, në paragrafin (1), fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Komisioni Rregullator i Energjetikës ndjek dhe ushtron mbikëqyrje të funksionimit të tregjeve të energjisë me qëllim që të:“.

Në pikën 1), pas fjalës „aftësia konkurruese“ shtohet presje dhe fjala „integriteti“.

Pas pikës 2), shtohet pikë e re 3) siç vijon:

„3) zbulojë dhe parandalojë tregtinë me produkte energjetike në tregun me shumicë të bazuar në informacione të brendshme dhe manipulim të tregjeve me shumicë me produkte energjetike, duke përfshirë edhe tentimin për manipulim të tregjeve me shumicë me produkte energjetike.“.

Në paragrafin (2), në pikën 13), pas fjalëve „dhe transmetim të energjisë“ shtohen fjalët: „gjendja teknike e sistemeve për transmetim dhe shpërndarje të energjisë para dhe pas rekonstruksionit ose riparimit të zbatuar pas avarisë së shkaktuar.“.

Në pikën 21), pas nënpikës 2, shtohet nënpika e re 3 siç vijon:

„- njoftim i konsumatorëve për pasojat nga mosfunksionimi i sistemeve për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë për shkak të zbatimit të rekonstruksionit ose riparimit pas avarisë së shkaktuar“.

Në pikën 29), shtohet pikë e re 30) siç vijon:

„30) aktivitetet për tregtim me produkte energjetike në tregun me shumicë me qëllim që të zbulohet dhe parandalohet tregtimi duke u bazuar në informacione të brendshme dhe manipulimin e tregut me produkte energjetike me shumicë, duke përfshirë edhe tentimin për manipulimin e tregut për produkte energjetike me shumicë.“.

Paragrafi (3) ndryshohet dhe bëhet:

„Komisioni Rregullator i Energjetikës miraton rregullore për mënyrën dhe procedurën e ndjekjes dhe ushtrimit të mbikëqyrjes mbi funksionimin e tregjeve të energjisë si edhe mënyrën e evidentimit të pjesëmarrësve në tregjet e energjisë me shumicë, përcaktimin e personave të cilëve u është i ndaluar tregtimi i bazuar në informacione të brendshme dhe përjashtimet, mënyra e publikimit të informacioneve të brendshme, lloji, përmbajtja, forma, mënyra dhe periudhat e dorëzimit dhe/ose publikimit të raporteve dhe të dhënave sipas nenit 25-a të këtij ligji“.

#### Neni 9

Pas nenit 25 shtohet titull i ri dhe neni i ri 25-a, siç vijon:

### **„Sigurim i integritetit dhe transparencës së tregjeve të energjisë**

#### Neni 25-a

(1) Ndalohet tregtimi i bazuar në informacione të brendshme, respektivisht personave që posedojnë informacione të brendshme lidhur me produktin energjetik në tregun me shumicë nuk guxojnë të:

1) shfrytëzojnë informacionet e brendshme gjatë blerjes ose shitjes ose tentimit për blerje ose shitje, për llogari të veten ose për llogari të palës së tretë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të produkteve energjetike në tregun me shumicë me të cilin kanë të bëjnë ato informacione,

2) zbardhin informacionet e brendshme të cilitdo personi tjetër, përveç nëse zbardhja e tillë bëhet gjatë ushtrimit të zakonshëm të veprimtarisë, profesionit ose detyrës së tyre, dhe

3) rekomandojnë ose të përmendim person tjetër, në bazë të informacioneve të brendshme, të blejë ose të shesë produkt energjetik në tregun me shumicë me të cilin ka të bëjë ky informacion.

(2) Ndalohet manipulimi i tregjeve të produkteve energjetike me shumicë, me çka manipulim i tregut të produkteve energjetike me shumicë është:

1) Ushtrimi i çfarëdo transaksionit ose dhënie e çfarëdo fleturdhërese për tregtim me produkte energjetike në tregun me shumicë, me të cilat:

- jepen ose me siguri do të jepen sinjale të rrejshme ose të orientuara gabimisht për ofertën, kërkesën ose çmimin e produkteve energjetike në tregun me shumicë;

- me ndihmën e një personi ose në bashkëpunim me disa persona sigurohet ose bëhet tentim që të sigurohet vendosje artificiale e çmimit të një ose disa produkteve energjetike në tregun me shumicë, përveç nëse personi që e ka zbatuar transaksionit ose e ka lëshuar urdhëresën për tregtim dëshmon se ka arsye legjitime për atë dhe se transaksioni ose urdhëri për tregtim është në përputhje me praktikat e pranuar në tregun përkatës të produkteve energjetike me shumicë, ose

- shfrytëzohet ose tentohet të shfrytëzohet mjet fiktiv ose çfarëdo forme tjetër e mashtrimit dhe shpifjes, që jep ose është e sigurt se do të japë sinjale të rrejshme ose të orientuara gabimisht për ofertën, kërkesën ose çmimet e produkteve energjetike në tregun me shumicë, ose

2) përhapje të informacioneve nëpërmjet mediave, internetit ose çfarëdo mënyre tjetër, që ofrojnë ose është e sigurt se do të japin sinjale të rrejshme ose të orientuara gabimisht për ofertën, kërkesën ose çmimet e produkteve energjetike në tregun me shumicë, duke përfshirë edhe përhapjen e thashethemeve ose lajmeve të orientuara gabimisht nëse personi që i përhapë e ka ditur ose është dashur ta dijë se informacionet janë të rrejshme ose të orientuara gabimisht.

(3) Ndalohet tentimi për manipulimin e tregut të produkteve energjetike me shumicë, me çka tentim për manipulim të tregut të produkteve energjetike me shumicë është:

1) realizimi i çfarëdo transaksioni, dhënie të çfarëdo fleturdhërese për tregtim ose ndërmarrje të çfarëdo mase tjetër që ka të bëjë me produkt të caktuar energjetik në tregun me shumicë me qëllim të:

- dhënies së sinjaleve të rrejshme ose të orientuara gabimisht për ofertën, kërkesën ose çmimin e produktit energjetik në tregun me shumicë;

- vendosjes artificiale të çmimit të një ose disa produkteve energjetike në tregun me shumicë, përveç nëse personi që e ka realizuar transaksionin ose e ka lëshuar fleturdhëresën për tregtim dëshmon se ka arsye legjitime për atë dhe se transaksioni ose fleturdhëresa për tregtim është në përputhje me praktikat e pranuar të tregut përkatës të produkteve energjetike me shumicë, ose

- shfrytëzimit të mjetit fiktiv ose çfarëdo forme tjetër të mashtrimit ose shpifjes, që jep ose është e sigurt se do të japë sinjale të rrejshme ose të orientuara gabimisht për ofertën, kërkesën ose çmimet e produkteve energjetike në tregun me shumicë,ose

2) përhapje të informacioneve nëpërmjet mediave, internetit ose çfarëdo mënyre tjetër, që ofrojnë ose është e sigurt se do të japin sinjale të rrejshme ose të orientuara gabimisht për ofertën, kërkesën ose çmimet e produkteve energjetike në tregun me shumicë.

(4) Pjesëmarrës në tregjet energjisë me shumicë me produkte energjetike është çdo person që ushtron transaksione ose jep fleturdhërese për realizimin e transaksioneve në ato tregje, e veçanërisht:

1) operatorët e sistemeve për transmetim dhe shpërndarje të energjisë elektrike dhe gazit natyror,

2) operatori i tregut me energji elektrike gjatë transaksioneve me energji elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme nga prodhuesit preferencial që shfrytëzojnë tarifë të preferenciale,

3) tregtarët dhe furnizuesit me energji elektrike dhe gaz natyror,

4) prodhuesit e energjisë elektrik që energjinë e prodhuar elektrike e shesin në tregun me shumicë,

5) konsumatorët të cilët kanë kapacitet të konsumit të energjisë elektrike ose gazit natyror gjatë shfrytëzimit të plotë të tëgjitha kapaciteteve prodhuese të konsumatorët që është e barabartë ose më e madhe se 600 GWh për periudhë prej një viti kalendarik dhe e përfshin konsumin e përgjithshëm të atij konsumatori si subjekt i veçantë ekonomik, me kusht që konsumi të zhvillohet në tregje me çmime të lidhura të shitjes me shumicë, me çka nuk merret parasysh

konsumi i stabilimenteve individuale nën kontrollin e një subjekti ekonomik me kapacitet të konsumit më të vogël se 600 GWhnë vit, nëse ato stabilimente gjenden në tregje të ndryshme relevante gjeografike dhe për shkak të kësaj nuk kanë ndikim të përbashkët në çmimet e produkteve energjetike në tregun me shumicë,

6) personat të cilët në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ndërmjetësojnë në dakordimin e transaksioneve me produkte energjetike në tregjet me shumicë.

(5) Pjesëmarrësit në tregjet e energjisë me shumicë, sipas paragrafit (4), pikat 1), 2), 3), 4), dhe 5), të këtij neni, janë të obliguar të parashtrajnë kërkesë për regjistrim në evidencën e pjesëmarrësve në tregun e energjisë me shumicë që e vendosë dhe udhëheqë Komisioni Rregullator i Energjetikës.

(6) Pjesëmarrësit në tregjet e energjisë me shumicë, sipas paragrafit (4) pikat 1), 2), 3), 4) dhe 5) të këtij neni, janë të obliguar të dorëzojnë raporte në Komisionin Rregullator të Energjetikës, si dhe të publikojnë informacione të brendshme në raport me kapacitetet dhe punën e tyre në tregjet e produkteve energjetike me shumicë, në përputhje me rregullën, sipas nenit 25, paragrafi (3) të këtij ligji.

(7) Nëse personi që në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së vet ndërmjetëson në dakordimin e transaksioneve me produkte energjetike në tregjet e energjisë me shumicë dyshon se një transaksion i caktuar mund të paraqesë tregtim të bazuar në informacione të brendshme, manipulim të tregut ose tentim për manipulim të tregut është i obliguar për këtë ta njoftojë Komisionin Rregullator të Energjetikës.

(8) Personi, sipas paragrafit (7) të këtij neni, është i obliguar të dorëzojë dhe zbatojë mekanizma efikasë për dallimin e tregtisë së bazuar në informacione të brendshme, manipulim në treg ose tentim për manipulim në treg”.

#### Neni 10

Në nenin 29, paragrafi (3) ndryshohet dhe bëhet:

„Sistemi tarifor me të cilin përcaktohen elementet për përlllogaritje të çmimeve të shitjes për energji elektrike nga furnizuesi universal, respektivisht çmimet e shitjes për gaz natyror nga furnizuesi me gaz natyror me detyrimin për shërbim publik duhet të bazohet në parimet, sipas nenit 28 paragrafi (4) të këtij ligji.“

Paragrafi (4) ndryshohet dhe bëhet:

„Ushtruesit e veprimtarive të rregulluara energjetike janë të obliguar t’i zbatojnë çmimet e përcaktuara në vendimin për çmime dhe tarifat e miratuara me zbatimin e rregulloreve dhe metodologjive, sipas nenit 28 të këtij ligji, dhe sistemet tarifore, sipas paragrafit (1) të këtij neni“.

Pas paragrafit (4) shtohen dy paragrafë të rinj (5) dhe (6) siç vijon:

„(5) Furnizuesi universal me energji elektrike dhe furnizuesi me gaz natyror me detyrim për shërbim publik janë të obliguar t’i formojnë çmimet e shitjes për energji elektrike, respektivisht gaz natyror me zbatimin e sistemit tarifor sipas paragrafit (3) të këtij neni.

(6) Komisioni Rregullator i Energjetikës i ndjekë mënyrën e zbatimit të sistemit tarifor, sipas paragrafit (3) të këtij neni, dhe nëse përcakton se çmimet e shitjes nuk janë në përputhje me sistemin tarifor merr vendim me të cilin do të obligojë furnizuesin t’i harmonizojë çmimet e shitjes me sistemin tarifor.“

#### Neni 11

Pas nenit 30 shtohen titulli i ri dhe neni i ri 30-a siç vijon:

## “Sajber siguria

### Neni 30-a

(1) Për shkak të sigurimit të sajber sigurisë së rrjeteve dhe/ose sistemeve informatike që i shfrytëzojnë në ushtrimin e veprimtarisë së operatorëve të sistemit të transmetimit elektrik dhe shpërndarjes elektrike dhe prodhuesve të energjisë elektrike të cilët menaxhojnë elektrocentralet me kapacitet të përgjithshëm të instaluar të barabartë ose më të madh se 200 MW ndërmarrin masa dhe aktivitete për shpalosjen e kërcënimeve dhe parandalimin e sajber sulmeve dhe incidenteve dhe vendosin mekanizma për përballje me kërcënimet ose pasojat nga sulmet dhe incidentet, si dhe për ripërtëritjen e rrjeteve dhe sistemeve deri në gjendjen në të cilën kanë qenë para sajber sulmit ose incidentit.

(2) Subjektet, sipas paragrafit (1) të këtij neni, veçanërisht janë të detyruar të:

1) emërojnë nëpunës për sajber siguri,

2) certifikohen sipas standardeve ndërkombëtare për siguri të rrjeteve, siguri informatike dhe sajber siguri,

3) miratojnë metodologji për vlerësimin e rreziqeve nga sajber sulmet dhe incidentet dhe plane operative për parandalim dhe reagim ndaj sajber sulmeve dhe incidenteve,

4) shkëmbejnë informacione për sajber kërcënime dhe incidente me Komisionin Rregullator të Energjetikës, e sipas nevojës edhe në mënyrë të ndërsjellë me operatorë të tjerë, dhe

5) miratojnë dhe zbatojnë program për trajnimin e të punësuarve lidhur me sajber sigurinë.

(3) Operatorët dhe prodhuesit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, janë të obliguar të dorëzojnë plane dhe raporte vjetore për zbatimin e detyrimeve, sipas paragrafit (1) të këtij neni, drejtuar Komisionit Rregullator të Energjetikës, më së voni deri më 31 janar të vitit rrjedhës, e nëse Komisioni Rregullator i Energjetikës vlerëson se është e nevojshme mundet edhe më shpesh.

(4) Komisioni Rregullator i Energjetikës, në përputhje me rregullat me të cilat rregullohet siguria e rrjeteve dhe sistemeve informatike, miraton rregulla për sajber siguri me të cilat rregullon më afër detyrimet për sigurimin e sajber sigurisë, respektivisht teknikat dhe masat dhe aktivitetet organizative që i ndërmarrin subjektet, sipas paragrafit (1) të këtij neni, për shkak të sigurimit të sajber sigurisë së rrjeteve dhe/ose të sistemeve informative që i shfrytëzojnë në ushtrimin e veprimtarisë, e veçanërisht:

1) përcaktim i infrastrukturës kritike në sektorin energjetik për të cilën Komisioni Rregullator i Energjetikës do të përcaktojë prioritet në sigurimin e sajber sigurisë,

2) standardet ndërkombëtare për sigurinë e rrjeteve, siguri informatike dhe sajber siguri sipas të cilave certifikohen operatorët dhe prodhuesit përkatës,

3) elementet themelore të metodologjisë për vlerësimin e rreziqeve nga sajber sulmet dhe incidentet dhe të planeve operative për parandalim dhe reagim ndaj sajber sulmeve dhe incidenteve,

4) mënyra dhe procedura për kontrollin e sigurisë së sistemeve të zbatuara informatike,

5) kërkesat që duhet t'i përmbushin pajisjet e reja dhe ekzistuese të lidhura me internetin ose që përdoren në rrjetet dhe sistemet që zbatojnë teknologji operative,

6) masat dhe aktivitete për parandalimin dhe/ose uljen e rreziqeve nga sajber sulmet dhe incidentet,

7) masat dhe aktivitetet për parandalimin dhe/ose uljen e rreziqeve nga sajber sulmet dhe incidentet të shkaktuar nga dhe të lidhur me domino-efektet,

8) mënyra, procedura dhe afatet për dorëzimin e njoftimit për sajber sulme dhe incidente të zbuluara deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës,

9) kushtet për emërimin e nëpunësit për sajber siguri dhe autorizimet dhe detyrat e tij,

10) elementet themelore të programit për zbatimin e trajnimeve për të punësuarit për sajber siguri, dhe



11) afatet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara me rregullat.”.

#### Neni 12

Në nenin 34, pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4) siç vijon:

„(4) Me përjashtim të dispozitave të paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni, në rast të gjendjes së shpallur të krizës, gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së luftës, epidemisë ose pandemisë, Komisioni Rregullator i Energjetikës mund të mbajë seanca përgatitore në procedurë dhe afate të përcaktuara në përputhje me rregulloren për punë të Komisionit Rregullator të Energjetikës.“.

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (5) dhe (6).

#### Neni 13

Në nenin 35, paragrafi (1), në pikën 1) pas fjalës: „dhënie“ vendoset presje dhe shtohen fjalët: „ndryshim, vazhdim dhe bartje“.

Pas pikës 2) shtohet pikë e re 3) siç vijon:

„3) kompensime nga procedura për përcaktimin e tarifave për mbeturina, respektivisht tarifa rregulatore për mbeturina“,

Në pikën 3) që bëhet pika 4) lidhësja “dhe” në fund të fjalisë fshihet

Në pikën 4) e cila bëhet pika 5) pika në fund të fjalisë zëvendosohet me lidhësen “dhe”.

Pas pikës 5) shtohet pikë e re 6) siç vijon:

„6) Kompensim i veçantë vjetor të cilin e paguajnë ofruesit e shërbimeve i përcaktuar si përqindje e përfshirjes së të ardhurave vjetore të ofruesve të shërbimit të realizuar nga dhënia e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale.“

Pas paragrafit (8) shtohet paragrafi i ri (9) siç vijon:

„(9) Komisioni Rregullator i Energjetikës mund të marrë vendim për ridedikimin e mjeteve sipas zërave të shpenzimit në kuadër të mjeteve të përgjithshme të aprovuara me planin financiar, nëse shpenzimet që janë objekt i ndryshimeve nuk kanë mund të parashikohen gjatë përpilimit të propozimit planit financiar, gjë që duhet të arsyetohet në vendimin dhe ndryshimi i zërit të mos jetë më i madh se 25 % të shumës së zërit në planin e aprovuar financiar.“.

#### Neni 14

Në nenin 37, paragrafi (1), në pikën 1), pas fjalëve “gaz natyror” shtohen fjalët “naftë e papërpunuar dhe derivate të naftës”.

Nënpika 1 ndryshohet dhe bëhet:

„- kundër akteve të operatorëve përkatës me të cilat fitohet qasja ose kyçja në sistemin përkatës, e në raport me energjinë termike dhe kundër akteve të operatorit përkatës me të cilat refuzohet kërkesa për shkyçje, si dhe kundër akteve me të cilat përcaktohet shuma e kompensimit dhe kushtet tjera për kyçje, e në raport me energjinë termike dhe kundër akteve me të cilat përcaktohet shuma e kompensimit dhe kushtet tjera për shkyçjen“.

Pika 3) ndryshohet dhe bëhet:

„ushtruesit e veprimtarive energjetike dhe konsumatorët kundër aktit individual të operatorëve në tregun përkatës të energjisë me të cilin refuzohet kërkesa për regjistrim në regjistrin përkatës ose merret vendim për të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga pjesëmarrja në tregun përkatës.“.

#### Neni 15

Në nenin 38, paragrafi (1) ndryshohet dhe bëhet:

„Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë energjetike pa licencë të lëshuar nga Komisioni Rregullator i Energjetikës“.

Pas paragrafit (8) shtohen dy paragrafë të rinj (9) dhe (10), siç vijon:

„(9) Licenca për ushtrimin e veprimtarisë energjetike prodhim të energjisë elektrike i jepet edhe personit juridik të regjistruar në regjistrin e personave të tjerë juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut që prodhon energji elektrike nga burimet e ripërtërishme.

(10) Bartësi i licencës është i obliguar që Komisionit Rregullator të Energjetikës t'i dorëzojë raport vjetor për punën e vet dhe për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në licencën për ushtrimin e veprimtarisë energjetike.“.

Paragrafi (9) bëhet paragrafi (11).

#### Neni 16

Në nenin 39, në paragrafin (2), pas pikës 2) shtohet pika e re 3), siç vijon:

„3) kur bartësi i licencës bën bartjen e pronësisë së elektrocentralit për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme, për punën e të cilit është lëshuar licenca, mbi person tjetër që i përmbushë kushtet për lëshimin e licencës“.

Pika 3) bëhet pika 4).

Në pikën 4) e cila bëhet pika 5) fjalët: „menaxhim personal, nëse miratohet plan për riorganizim“ zëvendësohen me fjalët: „riorganizim që zbatohet sipas planit të aprovuar për riorganizim“, ndërsa fjala: „licencë“ zëvendësohet me fjalën: „licenca“.

#### Neni 17

Në nenin 40, paragrafi (4), fjalët „Nga një kopje nga aktvendimi“ zëvendësohen me fjalën „Aktvendimi“, ndërsa pas fjalëve „Komisioni rregullator i energjetikës“ shtohet fjala „e“.

#### Neni 18

Në nenin 53, në pikën 11), lidhëza „ose“ zëvendësohet me pikëpresje .

Në pikën 12), pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhësen “ose”

Pas pikës 12) shtohet pikë e re 13) siç vijon:

13) mundësia që të ndërtohet ose përdoret stabiliment për magazinimin e energjisë elektrike.

#### Neni 19

Në nenin 55 ndryshohet fjalia hyrëse siç vijon:

„Kërkesës për marrjen e autorizimit, sipas nenit 54, paragrafi (2) të këtij ligji, parashtrihen dëshmitë dhe të dhënat siç vijon:“

Në pikën 2), para fjalëve: “pëlqim për bashkëngjitje” shtohet fjala: “preliminare”.

Në pikën 4), pas fjalës: „planifikim“ shtohet presje dhe fjalët: “respektivisht vendimi i Qeverisë për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e elektrocentralit fotovoltai në truallin e parashikuar për ndërtim në procedurë të rregulluar me ligj”.

Në pikën 11), lidhëza „dhe“ në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje.

Pas pikës 11) shtohet pikë e re 12) siç vijon:

„12) fletë pronësi e truallit në të cilin planifikohet të ndërtohet objekti energjetik, nga i cili mund të përcaktohet e drejta e pronësisë, respektivisht e shfrytëzimit të truallit, dhe”.

Pika 12) bëhet pika 13).

Pas paragrafit 1 shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3) siç vijon:

„(2) Dëshmitë dhe të dhënat për përmbushjen e kushteve, sipas paragrafit (1) pikat 2, 3, 4, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij neni, i siguron personi i autorizuar nga organi që e udhëheq procedurën për lëshimin e autorizimit, që është i detyruar në afat prej tre ditëve nga pranimi i kërkesës t'i kërkojë dëshmitë nga organi kompetent publik.

(3) Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik është i obliguar që dëshmitë e kërkuara, sipas paragrafit (2) të këtij neni, t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga pranimi i kërkesës.“.

#### Neni 20

Në nenin 60, në paragrafin (1), pas fjalës “fuqi” shtohen fjalët: “me mundësi për vazhdimin e vlefshmërisë së tij, por jo më gjatë se tri vite”.

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) siç vijon:

„(3) Me kërkesë të bartësit të autorizimit dorëzuar para skadimit të afatit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, Qeveria, respektivisht këshilli i njësisë së vetëqeverisjes lokale do të ndryshojë ose plotësojë autorizimin e lëshuar për ndërtimin e objekteve të reja ose zgjerimin e objekteve ekzistuese për prodhimin e energjisë elektrike, respektivisht energjisë termike, duke përfshirë edhe vazhdimin e afatit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, nëse kërkesa është në përputhje me kriteret, sipas nenit 53 të këtij ligji, në bazë të të cilit është lëshuar autorizimi, përveçse në raport me kapacitetin e instaluar të objektit.“.

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

#### Neni 21

Në nenin 61, pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4) siç vijon:

„(4) Nëse ndonjë masë tjetër për mbështetje sipas nenit 186 të këtij ligji ndahet nëpërmjet procedurës së tenderimit zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat sipas nenit 188 të këtij ligji“.

Paragrafët (4), (5) dhe (6) bëhen paragrafë (5), (6) dhe (7).

#### Neni 22

Në nenin 62 paragrafi (2) ndryshohet dhe bëhet:

„Sistem i ri për shpërndarjen e gazit natyror në rajon të caktuar nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të ndërtojë dhe atë ta menaxhoë edhe ndërmarrje publike ose person tjetër juridik i themeluar për këtë dedikim nga njësia e vetëqeverisjes lokale nëse rajoni nuk është i përfshirë me procedurën për ndarjen e marrëveshjes, sipas paragrafit (1) të këtij neni.“

Në paragrafin (5) fjalët: „paraprakisht është planifikuar ndërtim i sistemit të ri për shpërndarjen e gazit natyror“ zëvendësohen me fjalët: „ka filluar procedura për ndarjen e marrëveshjes, sipas paragrafit (1) të këtij neni“.

#### Neni 23

Në nenin 65, paragrafi (3), në pikën 4) fjalët: dokumentacion urbanistik-planifikues zëvendësohen me fjalët “plan urbanistik”.

#### Neni 24

Në nenin 67, në paragrafin (4,) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: „si dhe përmbajtja e autorizimit.“.

Paragrafi (8) ndryshohet dhe bëhet:

„Shfrytëzimi i përçuesit të drejtpërdrejt nuk do të ndikojë në realizimin e së drejtës së shfrytëzuesit të përçuesit të drejtpërdrejt për qasje në sisteme dhe kyçe në rrjete për transmetimin ose shpërndarjen e energjisë elektrike ose gazit natyror në përputhje me dispozitat nga ky ligj“.

#### Neni 25

Pas nenit 67 shtohet titull i ri dhe neni i ri 67-a, siç vijon:

## „Projekte strategjike të infrastrukturës energjetike

### Neni 67-a

(1) Projekt strategjik për infrastrukturë elektroenergjetike është projekt i cili mundëson furnizim të sigurt me energji elektrike, integrim dhe rritje të aftësisë konkurruese në tregun e energjisë elektrike, uljen e qasjeve të ngushta të infrastrukturës elektroenergjetike dhe rritjen e fleksibilitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergjetik, ndërlidhje të prodhuesve nga burimet e ripërtërishme për prodhimin e energjisë elektrike dhe transmetimin e energjisë së prodhuar elektrike deri te konsumatorët dhe vendet për magazinim, mes të tjerash, nëpërmjet interoperabilitetit, ndërlidhjeve përkatëse, si dhe funksionimit të sigurt dhe të besueshëm të sistemit, e me të cilin parashikohet:

1) Ndërtimi i largpërçuesve të tensionit të lartë, të projektuar për tension prej së paku 110 kV, dhe kablllo nëntokësor dhe nënujor për transmetim, të projektuar për tension prej së paku 150 kV;

2) Ndërtim i objekteve me infrastrukturë mbitokësore ose nëntokësore ose vende gjeologjike në të cilat vazhdimisht ose përkohësisht magazinohet energjia elektrike, nëse planifikohet lidhja e tyre e drejtpërdrejt me largpërçuesit e tensionit të lartë prej së paku 110 kV;

3) Furnizim dhe instalim të pajisjes ose instalimit të domosdoshëm për punë të sigurtë dhe efikase të sistemeve të përmendura në pikat 1) dhe 2) të këtij paragrafi, duke përfshirë edhe sistemet për mbrojtje, ndjekje dhe kontroll në të gjitha nivelet e tensionit dhe trafostacioneve;

4) Furnizim dhe instalim të pajisjes ose instalim të sistemit për transmetim të energjisë elektrike ose sistemin për shpërndajre të energjisë elektrike në rrjetin me tension të mesëm, me të cilin mundësohet:

- komunikim i dyanshëm digjital në kohë reale ose afër kohës reale,

- ndjekje dhe udhëheqje interaktive dhe e mençur me prodhimtarinë, transmetimin, shpërndarjen dhe konsumin e energjisë elektrike në kuadër të sistemit elektroenergjetik me qëllim të zhvillimit të sistemit që do të mundësojë punë të interguar efikase të të gjithë shfrytëzuesve të lidhur me të dhe

- sistem efikas dhe i qëndrueshëm në aspektin ekonomik i transmetimit të energjisë elektrike me humbje të ulëta dhe nivel të lartë të cilësisë, sigurisë në furnizimin dhe

5) ndërtim i rrjeteve të mençura përdorimi i të cilave përfshin zbatimin e teknologjive dhe procedurave me të cilat mundësohet arritje e integritetit efektiv të të gjithë shfrytëzuesve që janë të lidhur me sistemin elektroenergjetik, veçanërisht prodhuesit e mëdhenj të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme ose burimeve shpërndarëse për prodhimin e energjisë elektrike dhe përfshirjen e shfrytëzuesve në menaxhimin e konsumit të tyre të energjisë.

(2) Projekti strategjik për infrastrukturë për gaz natyror dhe bogaz është projekt që mundëson integrimin dhe rritjen e aftësisë konkurruese në tregun e gazit, uljen e pikave të ngushta dhe rritjen e fleksibilitetit të sistemit, sigurisë në furnizim nëpërmjet ndërlidhjes dhe qasjes deri te burimet e ndryshme të furnizimit, furnizues dhe ruta për furnizim, ulje të emisioneve të gazrave serrë ose emisioneve në ndotjen lokale dhe rritjen e përdorimit të biogazit, e me të cilin parashikohet:

1) ndërtimi i tubacion për transmetimin e gazit natyror dhe bogazit që janë pjesë e rrjetit që kryesisht është i përbërë prej gazsjellësve nën tension të lartë, me përjashtim të tubacioneve me tension të lartë që përdoren për nevojat e prodhimit ose për shpërndarje lokale të gazit natyror;

2) ndërtimi i objekteve nëntokësore për magazinim të lidhura me gazsjellësit me tension të lartë, sipas pikës 1) të këtij paragrafi;

3) ndërtimi i objekteve për pranim, magazinim dhe gazifikimi të sërishëm ose demokmpresion të gazit të lëngshëm natyror (LNG) ose gaz të komprimuar natyror (CNG); dhe

4) furnizim dhe instalim të pajisjes ose instalimit të domosdoshëm në mënyrë që sistemi të punojë sigurt, në mënyrë efikas ose të mundësojë kapacitet të dyanshëm, duke përfshirë edhe stacione të kompresionit.

(3) Projekte strategjike për infrastrukturën për naftë të papërpunuar është projekt që mundëson siguri në furnizimin që do ta zvogëlonte pavarësisht nga një burim i furnizimit, shfrytëzim efika dhe të qëndrueshme të resurseve nëpërmjet zbutjes së rreziqeve mbi mjedisin jetësor ose interoperabilitetin me infrastrukturë tjetër për naftë të papërpunuar, e me të cilën parashikohet:

1) ndërtim i tubacioneve që përdoren për transmetimin e naftës së papërpunuar;

2) ndërtimi i stacioneve të pompimit dhe objekte për magazinim të domosdoshme për punën e tubacioneve me naftë të papërpunuar; dhe

3) furnizim dhe instalim i pajisjes ose instalimit që i mundëson sistemit për transmetim dhe magazinim të naftës së papërpunuar të punojë në mënyrë të sigurt dhe efikase, duke përfshirë mbrojtjen, ndjekje dhe kontrollin e sistemit dhe pajisjeve me qarkullim reverzibil.

(4) Qeveria, në procedurën e përcaktuar me rregullat me të cilat rregullohen investimet strategjike, pas mendimit të siguruar paraprakisht nga Komisioni Rregullator i Energjetikë që është përpiluar në përputhje me rregullat, sipas nenit 24, paragrafi (1) pika 1) nënpika 22 e këtij ligj, merr vendim për shpalljen e projektit të infrastrukturës energjetike, sipas paragrafëve (1), (2) dhe (3) të këtij neni, për projekt strategjik investues.

(5) Qeveria, në procedurën e përcaktuar me rregullat me të cilat rregullohen investimet strategjike, pas mendimit të siguruar paraprakisht nga Komisioni Rregullator i Energjetikë është përpiluar në përputhje me rregullat, sipas nenit 24, paragrafi (1), pika 1) nënpika 22 të këtij ligj, mund të propozojë që grupet për energji elektrike dhe gaz natyror që marrin pjesë në procesin e seleksionim të PECE/PMI projekteve të Bashkësisë energjetike ta përfshijnë projektin në listën e PECE projekteve, respektivisht PMI projekteve.

(6) Nëse Komisionit Rregullator të Energjetikës, në bazë të analizës së shpenzimeve dhe/ose konsultimit paraprak me trupat rregullator nga palët e prekura kontraktuese dhe/ose pjesëmarrës në Marrëveshjen për Bashkësi energjetike, përcaktoi se ekziston rreziku për realizimin dhe funksionimin e projektit, në mendimin, sipas paragrafit (4), respektivisht paragrafi (5) të këtij neni, mund t'i propozojë Qeverisë të miratojë masa nxitëse në përputhje me rregullat me të cilat rregullohet ndarja e ndihmës shtetërore, e veçanërisht në raport me realizimin e investimeve të planifikuar, njohjen e shpenzimeve të shkaktuara para lëshimit në përdorim të projektit, sigurimin e kthimit plotësues të kapitalit të investuar në projektin dhe masa të tjera të nevojshme dhe përkatëse. “.

#### Neni 26

Në nenin 69, në paragrafin (1), në pikën 7) fshihet lidhëza “dhe” në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 8), pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhësen “dhe”.

Pas pikës 8) shtohet pikë e re 9) siç vijon:

„9) operatori magazinës për energji elektrike“.

#### Neni 27

Në nenin 70, paragrafi (3), pas fjalëve „tregu i energjisë elektrike“, shtohen fjalët: „të sigurojë karburante të tjera, si dhe të ndërmarrë veprime të tjera në tregjet për energji“.

Në paragrafin (4) numri „250“ zëvendësohet me numrin „200“.

#### Neni 28

Pas nenit 70 shtohet titull i ri dhe neni i ri 70-a siç vijon:

## „Operatori i magazinës për energji elektrike

### Neni 70-a

(1) Operatorii magazinës për energji elektrike në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret dhe rregullat e miratuar në përputhje me këtë ligj:

1) i ofron shërbime sistemore operatorit të sistemit për transmetim të energjisë elektrike për shkak të balancimit të sistemit, në përputhje me kapacitetet dhe kërkesat teknike të përcaktuara në rregullat për balancimin e sistemit elektroenergjetik dhe rregullave të rrjetit për transmetimin e energjisë elektrike,

2) siguron qasje të sasive të kontraktuara të energjisë elektrike dhe/ose shërbimeve sistemore deri në pikëne pranimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike ose shpërndarjes së energjisë elektrike në përputhje me kushtet dhe detyrimet nga licencat e tij, si dhe me kontratën për kyçje,

3) dorëzon raporte, të dhëna dhe informacione drejtuar operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike ose sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në përputhje me rregullat përkatëse të rrjetëzuara,

4) i dorëzon operatorit të sistemit për transmetimin e energjisë elektrike dhe operatorit të tregut të energjisë elektrike të dhëna dhe informacione nga kontratat për blerje dhe shitje të energjisë së magazinuar elektrike, dispozicioni i kapaciteit magazinuar dhe/ose shërbime sistemore, përveç të dhënave afariste-financiare.

(2) Operatorii sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe operatorii i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike nuk mund të jenë pronarë, të ndërtojnë, të udhëheqin ose të jenë operatorë të stabilimentit për magazinimin e energjisë elektrike, përveç nëse në përputhje me rregullat përkatëse të rrjetit stabilimenti paraqet komponentin e plotë të integruar të rrjetit të transmetim, respektivisht shpërndarjes së energjisë elektrike, që përdoret për sigurimin e punës së sigurt dhe të besueshme të sistemit, por jo edhe për sigurimin e shërbimeve për balancimin ose udhëheqjen ngulfatjet.

(3) Kushtet tekniko-teknologjike dhe mënyra e kyçjes, si dhe metodologjia e përcaktimit të përlllogaritjes për kyçjen e stabilimentit për magazinimin e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, respektivisht shpërndarjes së energjisë elektrike rregullohen në rregulla përkatëse të rrjetëzuara.”.

### Neni 29

Në nenin 78, në paragrafi (2), pas pikës 27) shtohen dy pika të reja 28) dhe 29) siç vijon:

„28) të marrë pjesë në procedurat e përlllogaritjes së koordinuar rajonale të kapaciteteve dhe bashkim të tregjeve të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe në përpilimin e kushteve dhe metodologjive për përlllogaritje të koordinuar të kapaciteteve dhe bashkim të tregjeve të energjisë elektrike;

29) të bashkëpunojë me operatoritë tregut të organizuar të energjisë elektrike në procedurat për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike;“.

Pikat 28) dhe 29) bëhen pika 30) dhe 31).

### Neni 30

Në nenin 83, paragrafi (1) ndryshohet dhe bëhet:

„Operatorii sistemit për transmetimin e energjisë elektrike është i obliguar çdo dy vjet të përgatisë plan për zhvillimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhë prej 10 viteve të ardhshme në të cilin, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat e rrjetit për transmetim të energjisë elektrike, duhet të përfshihen të gjitha informacionet e nevojshme për zgjerimin dhe sendërtimin e sistemit për transmetimin e energjisë elektrike duke përfshirë edhe

nevojat dhe mundësitë për ndërtim dhe kyçje në stabilimentet për magazinimin e energjisë elektrike, si dhe prioritetet për ndërtimin e përzuesve të ri intekonektues të harmonizuar me operatorëte sistemeve të transmetimit të energjisë elektrike në rajon. Operatorii sistemit të transmetimit të energjisë elektrike më së voni më 1 tetor në vitin në të cilin aprovohet plani fillon procedura për harmonizim në raport me zgjerimet dhe sendërtimet e nevojshme të sistemit për transmetimin e energjisë elektrike për shkak të mundësimit të ndërtimit të kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme dhe realizimin e qëllimeve kombëtare dhe trajktores indikative për burime të ripërtërishme të energjisë, efikasitetit energjetik, uljen e emetimeve të gazrave serrë dhe rritjen e sigurisë në furnizimin me energji elektrike nga planim i përgatitur me Ministrinë që përfundon më së voni deri më 25 tetor. Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike e dorëzon planin e harmonizuar për aprovim në Komisionin Rregullator të Energjetikës më së voni deri më 31 tetor në vitin kalendarik në të cilin përgatitet dhe pas aprovimit të marrë, e aprovon planin dhe e publikon në ueb faqen e vet.“.

Paragrafi (2) ndryshohet dhe bëhet:

„Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike përgatitë dhe më së voni deri më 31 tetorë çdo dy vite dorëzon në Ministri dhe në Komisionin Rregullator të Energjetikës vlerësim të përshtatshmërisë së sistemit të transmetimit të energjisë elektriketë Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhë prej dhjetë viteve“.

Në paragrafin (3), në pikën 1), lidhëza „dhe“ në fund të fjalisë zëvendësohet me presje.

Në pikën 2), pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhësen „dhe“.

Pas pikës 2) shtohet pika e re 3) siç vijon:

„3) ndikimi mbi rritjen e numrit të elektrocentraleve që përdorin burime të ripërtërishme të energjisë dhe shpërndarjen hapësinore të tyre.“.

#### Neni 31

Në nenin 84, pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) siç vijon:

„(3) Komisioni Rregullator i Energjetikës, në bazë të kërkesës së parashtruar nga operatori i sistemit për transmetimin e energjisë elektrike, mund të marrë vendim për përjashtim nga zbatimi i detyrimeve të caktuara nga rregullata e rrjetit për transmetimin e energjisë elektrike.

(4) Komisioni Rregullator i Energjetikës miraton rregulla për përjashtim nga zbatimi i detyrimeve të caktuara nga rregullat e rrjetit për transmetimin e energjisë elektrike me të cilat veçanërisht rregullohen:

1) kriteret në bazë të të cilave ndahet përjashtim të zbatimit të detyrimeve të caktuara nga rregullat e rrjetit për transmetimin e energjisë elektrike,

2) forma, përmbatja dhe mënyra e dorëzimit të kërkesës për përjashtim nga zbatimi i detyrimeve të caktuara nga rregullat e rrjetit për transmetimin e energjisë elektrike,

3) dokumentacioni i nevojshëm që dorëzohet me kërkesën, sipas pikës 2) të këtij paragrafi, dhe

4) procedura dhe afatet për veprim ndaj kërkesës, sipas pikës 2) të këtij paragrafi.“.

#### Neni 32

Pas nenit 85 shtohet neni i ri 85-a siç vijon:

##### „Neni 85-a

(1) Operatorii sistemit për transmetim të energjisë elektrike, pas aprovimit paraprak nga Komisioni Rregullator i Energjetikës, miraton rregulla me të cilat rregullohen kushtet dhe procedurat për përllogaritje të koordinuar të kapaciteteve, si dhe procedurën dhe mënyrën e publikimit të të dhënave nga përllogaritjet që i publikon në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në ueb-faqen e vet.

(2) Rregullat sipas paragrafit (1) të këtij neni duhet të:

- 1) jenë në përputhje me mundësitë teknike të sistemit për transmetim të energjisë elektrike,
- 2) mundësojnë siguri në punën e sistemit për transmetim të energjisë elektrike,
- 3) sigurojnë përlllogaritje optimale të kapaciteteve ndërkufitare,
- 4) përmirësojnë transparencën dhe besueshmërinë e informacioneve,
- 5) kontribuojnë drejt efikasiteti dhe zhvillimit afatgjatë të sistemit për transmetim të energjisë elektrike,

6) jenë në përputhje me nevojën e tregut të rregulluar jodiskriminues të energjisë elektrike dhe formimit jodiskriminues të çmimit të energjisë elektrike.

7) jenë në përputhje me detyrimet që për Republikën e Maqedonisë së Veriut rezultojnë nga marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare dhe kanë të bëjnë me formimin e tregut rajonal të energjisë elektrike, si dhe për detyrimet e operatorit të sistemit për transmetim të energjisë elektrike që rezultojnë nga anëtarësimi në ENTSO-E dhe organizata të tjera ndërkombëtare”.

#### Neni 33

Në nenin 88, paragrafi (2), në pikën 1), fjala „administrim“ zëvendësohet me fjalët: „organizim dhe udhëheqje“.

Në pikën 11), pika në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje.

Pas pikës 11) ,shtohet pika e re 12) siç vijon:

“12) parashikime për prodhimtarinë e parashikuar të energjisë elektrike nga prodhues preferencial të cilët shfrytëzojnë tarifë preferenciale,

13) administrim (lëshim, bartje, heqje, anulim dhe njohje) të garancive për origjinë dhe udhëheqje të regjistrimit të garancive për origjinë.“.

#### Neni 34

Në nenin 90, paragrafin (2), në pikën 1), pas fjalës „rajoni“ shtohen fjalët „dhe Europa, nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale, si dhe i përgatitë metodologjitë dhe rregullat për bashkimin e tregjeve një ditë më parë dhe në ditën rrjedhëse në pëlqim me marrëveshjet e lidhura bilaterale dhe multilaterale“.

#### Neni 35

Në nenin 92, paragrafi (1), pas pikës 6) shtohet pika e re 7) siç vijon:

Pas pikës 6) shtohet pikë e re 7) në të cilën thuhet:

„7) ndërmarrje e masave të përcaktuara ndaj pjesëmarrësve në treg në rast të mospërbushjes së detyrimeve të tyre”.

#### Neni 36

Në nenin 94, paragrafi (2) ndryshohet dhe bëhet:

„Operatori sistemit për shpërndarjen e energjisë elektrike është i obliguar çdo vit të përgatisë plan për zhvillim të sistemit për periudhë prej pesë viteve, në të cilin duhet të përfshihen informacione për zhvillimin e sistemit për shpërndarje të energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e rrjetit për shpërndarje dhe informacionet e dorëzuara nga institucionet kompetent për nevojat e kyçjes së shfrytëzuesve të ri në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe nevojat dhe mundësitë për ndërtimin dhe kyçje në stabilimentet për magazinimin e energjisë elektrike. Operatori sistemit për shpërndarjen e energjisë elektrike më së voni më 1 tetor në vitin në të cilin aprovohet plani, fillon procedurën për harmonizimin në raport me zgjerimet dhe sendërtimet e nevojshme të sistemit për shpërndarjen e energjisë elektrike për shkak të mundësive për ndërtimin e kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme dhe realizimin e qëllimeve kombëtare dhe trajektores indikative për burime të



ripërtërishme të energjisë, efikasitet energjetik, ulje të emisioneve të gazrave serrë dhe rritjen e sigurisë në furnizimin me energji elektrike nga plani i përgatitur me Ministrinë që përfundon më së voni deri më 25 tetor. Operatori isistemit për shpërndarjen e energjisë elektrike e dorëzon planin e harmonizuar për aprovim në Komisionin Rregullator të Energjetikës më së voni deri më 31 tetor në vitin kalendarit në të cilin përgatitet plani dhe pas aprovimit të marrë, e miraton planin dhe e publikon në ueb faqen e vet”.

Në paragrafin (4) në fjalinë e dytë pas fjalëve: „investimet e parashikuara“ shtohet presje dhe fjalët: „si dhe ndikimi mbi rritjen e numrit të elektrocentraleve që përdorin burime të ripërtërishme të energjisë dhe shpërndarjen hapësinore të tyre“.

#### Neni 37

Në nenin 100, paragrafi (5), në pikën 10) fshihet lidhëza „dhe“ në fund të fjalisë fshihet.

Në pikën 11) pika në fund të fjalisë zëvendoshet me lidhësen „dhe“.

Pas pikës 11) shtohet tpika e re 12) siç vijon:

„12) furnizojë energji elektrike për konsumatorët e vet“.

Pas paragrafit (5) shtohet paragrafi i ri 1(6) siç vijon:

„(6) Furnizuesi me energji elektrike është i obliguar të sigurojë besueshmërinë e të dhënave nga marrëveshjet e lidhura në tregun me marrëveshje bilaterale, si dhe t’i realizojë sasitë e energjisë elektrike që i ka furnizuar për shkak të përmbushjes së detyrimeve nga ato marrëveshje.“.

#### Neni 38

Në nenin 101, paragrafi (1), pika 3) ndryshohet dhe bëhet:

“i formon çmimet e shitjes për energji elektrike me zbatimin e sistemit tarifor, sipas nenit 29, paragrafi (3) të këtij ligji, vetëm kur i furnizon amvisëritë dhe konsumatorët e vegjël“,

Në pikën 6) fjala „furnizojë“ zëvendësohet me fjalët „zbaton procedura për furnizim me“.

#### Neni 39

Në nenin 105, paragrafi (4) ndryshohet dhe bëhet:

„Tregtari me energji elektrike është i obliguar të sigurojë besueshmërinë e të dhënave nga marrëveshjet e lidhura në tregun me marrëveshje bilaterale si dhe t’i realizojë sasitë e energjisë elektrike që i ka furnizuar për shkak të përmbushjes së detyrimeve nga ato marrëveshje.“.

#### Neni 40

Në nenin 116, paragrafi (2), në pikën 17) fshihen fjalët: „dhe grupe balancimi“.

#### Neni 41

Në nenin 121, paragrafi (2), në pikën 7) fshihen fjalët: „dhe grupe balancimi“.

#### Neni 42

Në nenin 137, paragrafi (1), pika 2) ndryshohet dhe bëhet:

“formon çmimin e shitjes të gazit natyror me zbatimin e sistemit tarifor, sipas nenit 29 paragrafi (3) të këtij ligji;“.

#### Neni 43

Në nenin 139, paragrafi (5) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjatë vlerësimit të ofertave të ofruara merren parasysh kriteret si vijon:

1) Marzhi i ofruar

2) Përvoja e ofertuesit në ushtrimin e veprimtarisë energjetik furnizim me gaz natyror,

- 3) Gjendja financiare e ofertuesit,
- 4) Aftësi teknike dhe/ose kuadri e ofertuesit.

Paragrafi (8) ndryshohet dhe bëhet:

„Deri në fillimin e punës së furnizuesit të ri me gaz natyror na rastin përfundimtar i zgjedhur në mënyrën e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, furnizimni në rastin përfundimtar e bën furnizuesi ekzistues në rastin përfundimtar, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në licencën“.

Pas paragrafit (8) shtohet paragrafi (9) siç vijon:

„(9) Nëse deri në zgjedhjen e furnizuesit me gaz natyror në rast të fundit furnizuesit ekzistues me gaz natyror në i ka skaduar ose do t'i skadojë vlefshmëria e licencës, Komisioni Rregullator i Energjetikës sipas detyrës zyrtare i jep licencë ose e vazhdon vlefshmërinë e licencës për furnizim me gaz natyror në rast të fundit, që është me vlefshmëri deri në ditën e lëshimit të licencës së furnizuesit me gaz natyror në rast të fundit të zgjedhur në procedurën, sipas paragrafit (1) të këtij neni.“.

#### Neni 44

Në nenin 144, në paragrafin (1), pas pikës 2) shtohen tri pika të reja 3), 4) dhe 5), siç vijon:

„3) mënyra e përcaktimit të llojeve të instrumenteve për sigurimin e pagesës për shërbimet për transportin e naftës së papërpunuar,

4) mënyra e harmonizimit me shfrytëzuesit e naftës-jellësit në raste të ndërprerjeve të planifikuara,

5) përmbajtja e planeve për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e naftës-jellësit, si dhe mënyra dhe procedura sipas të cilës shfrytëzuesit e naftës-jellësit i dorëzojnë të dhënat e domosdoshme për përpilimin e atyre planeve;“.

Pikat 3), 4), 5) dhe 6) bëhen pika 6), 7), 8) dhe 9).

#### Neni 45

Në nenin 145, në paragrafin (1), pas pikës 2) shtohet tri pika të reja 3), 4) dhe 5), siç vijon:

„3) mënyra e përcaktimit të llojeve të instrumenteve për sigurimin e pagesës për shërbimet për transportin e derivateve të naftës,

4) mënyra e harmonizimit me shfrytëzuesit e produktsjellësit në raste të ndërprerjeve të planifikuara,

5) përmbajtja e planeve për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e produktsjellësit, si dhe mënyra dhe procedura sipas të cilës shfrytëzuesit e produktsjellësit i dorëzojnë të dhënat e domosdoshme për përpilimin e atyre planeve;“.

Pikat 3), 4) 5), dhe 6) bëhen pika 6), 7), 8) dhe 9).

#### Neni 46

Pas nenit 145 shtohen dy nene të reja 145-a dhe 145-b, siç vijon:

##### „Neni 145-a

(1) Ushtruesit e veprimtarive energjetike transport të naftës së papërpunuar nëpërmjet naftës-jellësit, respektivisht transportit të derivateve të naftës nëpërmjet produktsjellësitjanë të obliguar t'u mundësojnë në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente qasje të dakorduar shfrytëzuesve të naftës-jellësit, respektivisht produktsjellësit për shkak të transportit të naftës së papërpunuar, respektivisht derivate të naftës, me kusht që të përmbushen kushtet teknike për qasjen e palës së tretë të përcaktuara në rregullat sipas neneve 144 dhe 145 të këtij ligji.

(2) Ushtruesi i veprimtarisë energjetike, sipas paragrafit (1) të këtij neni, dhe shfrytëzuesit i naftës-jellësit, respektivisht produktsjellësi, pas kërkesës së parashtruar nga shfrytëzuesi, lidhin marrëveshje për qasje me të cilën në përputhje me rregullat, sipas neneve 144 dhe 145 të këtij ligji, veçanërisht rregullohen:

- 1) të dhënat për pikën e pranimit dhe pikën e dorëzimit,
- 2) dinamika e transportit, cilësia e naftës së papërpunuar, respektivisht derivatit të naftës,
- 3) kompensimi për transportin e realizuar, si dhe llojet e instrumenteve për sigurimin e pagesave,

- 4) mënyrë për zgjidhjen e kontesteve, dhe

- 5) dënime kontraktuale për devijime të palejueshme në raport me sasinë e dakorduar dhe cilësinë e përcaktuar të transportit të naftës së papërpunuar, respektivisht derivatit të naftës në përputhje me rregullën, sipas nenit 150, paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Ushtruesi i veprimtarisë energjetike sipas paragrafit (1) të këtij neni është i obliguar të sigurojë besueshmërinë e të dhënave afariste që shfrytëzuesit e naftës-jellësit, respektivisht produktsjellësit, ia dorëzojnë për shkak të lidhjes së marrëveshjeve, sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Ushtruesi i veprimtarisë energjetike, sipas paragrafit (1) të këtij neni, mund ta refuzojë me aktvendim kërkesën për qasje për arsye të:

- 1) mungesës së kapacitetit,
- 2) pengesave të reparit ose ngarkim të tepërt të naftës-jellësit, respektivisht produktsjellësit,
- 3) rrezikim të sigurisë ose funksionalitetit të naftës-jellësit, respektivisht produktsjellësit,
- 4) cilësi joadekuate e naftës së papërpunuar, respektivisht të derivatit të naftës, e në përputhje me rregullën, sipas nenit 150, paragrafi (1) të këtij ligji, ose

- 5) kushte të tjera të parashikuara në rregullat, sipas neneve 144 dhe 145 të këtij ligji.

(5) Aktvendimi, sipas paragrafit (4) të këtij neni, duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë të detajuar, ndërsa miratohet në afat prej pesë ditësh të punës nga pranimi i kërkesës për qasje.

(6) Kundër aktvendimit sipas paragrafit (4) të këtij neni shfrytëzuesi mund të parashtrojë ankesë në Komisionin Rregullator të Energjetikës, në përputhje me rregullat për veprim ndaj kundërshtimeve, sipas nenit 37 të këtij ligji.

#### Neni 145-b

(1) Ministri miraton metodologji për përcaktimin e shumës së kompensimit për transportin e realizuar nëpërmjet naftës-jellësit, respektivisht produktsjellësit, të bazuar në parimet e objektivitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit dhe me të cilën sigurohet:

- 1) baraspeshim i interesave të ushtruesit të veprimtarisë energjetike transport të naftës së papërpunuar nëpërmjet naftës-jellësit, respektivisht transport të derivateve të naftës nëpërmjet produktsjellësit dhe shfrytëzuesve të naftës-jellësit, respektivisht produktsjellësit, si dhe mbrojtjen e shfrytëzuesve nga çfarëdo keqpërdorimi të pozicionit dominues në treg,

- 2) kompensim të shpenzimeve të arsyeshme, nxitje të punës efikase si dhe përvetësim të hyrjes përkatëse të kapitalit të ushtruesit të veprimtarisë energjetike transport të naftës së papërpunuar nëpërmjet naftës-jellësit, respektivisht transport të derivateve të naftës nëpërmjet produktsjellësit dhe

- 3) mjete financiare të domosdoshme për investime me të cilat do të sigurohet funksionim dhe zhvillim i qëndrueshëm dhe i sigurt i naftës-jellësit, respektivisht produktsjellësit.

(2) Ushtruesi i veprimtarisë energjetike transport të naftës së papërpunuar nëpërmjet naftës-jellësit, respektivisht transport të derivateve të naftës nëpërmjet produktsjellësit, më së voni deri më 31 tetor në vitin rrjedhës dorëzon për aprovim në Qeveri listë tarifore për ushtrimin e transportit nëpërmjet naftës-jellësit, respektivisht produktsjellësit, të përpunuar në bazë të metodologjisë, sipas paragrafit (1) të këtij neni, për ushtrimin e transportit nëpërmjet naftës-jellësit, respektivisht produktsjellësit, që zbatohet nga dita e parë e vitit të radhës.

(3) Me kërkesën listën tarifore, sipas paragrafit (2) të këtij neni, dorëzohet dokumentacioni vijues:

1) raporte financiare me të gjitha shtojcat në përputhje me standardet e miratuara ndërkombëtare për njoftim financiar të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me raport të revizorit të autorizuar,

2) financiaro-kontabilist dhe tekniko-ekonomik dhe të dhëna dhe informacione të tjera, duke përfshirë edhe të dhëna për sasitë e transportuara të naftës së papërpunuar dhe/ose derivate të naftës në tre vitet paraprake dhe

3) plane për investim për pesë vitet e ardhshme, me përshkrim dhe arsyetim për arsyeshmërinë ekonomike dhe energjetike të çdo investimi ndaras, si dhe të dhëna për nivelin e realizimit të investimeve deri në ditën e dorëzimit të listës tarifore.

(4) Qeveria, pas mendimit paraprak të Ministrisë dhe Komisionit Rregullator të Energjetikës, e aprovon listën tarifore, sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(5) Në procedurën për aprovimin e listës tarifore, sipas paragrafit (2) të këtij neni, krahas dokumentacionit, sipas paragrafit (3) të këtij neni, Qeveria mund të kërkojë nga ushtruesi i veprimtarisë energjetike të dorëzojë edhe dokumente, informacione dhe të dhëna të tjera me rëndësi për aprovimin e listës tarifore.“.

#### Neni 47

Në nenin 155, paragrafi (1), në pikë 11), pas fjalës: „energji“ shtohen fjalët: „dhe në ueb faqen e vet të publikojë informacione për gjendjen teknike të sistemit para dhe pas rekonstruksionit ose riparimit të zbatuar pas avarisë së ndodhur“.

#### Neni 48

Në nenin 156, paragrafi (4) ndryshohet dhe bëhet:

“Operatori i sistemit për shpërndarjen e energjisë termike është i obliguar ta blejë energjinë termike të realizuar nga prodhuesit e energjisë termike në sistemin e shpërndarjes, nëse çmimi i energjisë termike i ofruar nga prodhuesi është më i ulët nga çmimi i rregulluar për energji termike të prodhuesit të rregulluar, për shumë që është më e madhe ose e barabartë me dallimin e nevojshëm minimal mes këtyre çmimeve të përcaktuar sipas metodologjisë nga Rregullorja, sipas nenit 153, paragrafi (5) të këtij ligji”.

Paragrafi (6) fshihet.

Paragrafi (7) bëhet paragrafi (6).

#### Neni 49

Titulli para nenit 160 ndryshohet dhe bëhet:

### **„Të drejtat dhe detyrime e konsumatorit**

#### Neni 160

(1) Konsumatorët e energjisë elektrike të lidhur në sistemin për shpërndarjen e energjisë termike kanë të drejtën e zgjedhjes së lirë nga cili furnizues do të furnizohen.

(2) Pronari me pjesë të veçantë në objekte banesore, banesore-afariste, afariste-banesore dhe afariste ku shpërndarja e kompensimit bëhet nëpërmjet një aparati matës, e që nuk është kyçur në sistemin për ngrohje qendrore ka për detyrë të paguaj një pjesë të kompensimit të përgjithshëm për energji termike që përcaktohet në përputhje me sistemin tarifor për energji termike.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, detyrimi për pagesën e një pjese të kompensimit të përgjithshëm për energji termike nuk ka të bëjë me pronarët që janë të liruar nga pagesa e kompensimit për energji termike në procedurë të përcaktuar në përputhje me rregullat për furnizimin e energjisë termike.“.

#### Neni 50

Në nenin 161, në paragrafin (3) numri „80“ zëvendësohet me numrin „700“.

#### Neni 51

Titulli para nenit 172 dhe neni 172 ndryshohet dhe bëhet:

### **„Plani për energji dhe klimë**

#### Neni 172

(1) Qeveria, me propozim të Ministrisë, miraton plan për energji dhe klimë, për periudhë prej së paku dhjetë viteve me projeksion prej 20 viteve shtesë. Planin e përpilon Ministria në bashkëpunim me ministrinë kompetente për punët nga fusha e mjedisit jetësor, me çka sigurohet pjesëmarrje e subjekteve tjera në nivel kombëtar dhe lokal, duke përfshirë institucione dhe organizata shkencore, arsimore dhe profesionale, si dhe të organeve dhe trupave në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, duke përfshirë edhe Sekretariatit e Bashkësisë Energjetike.

(2) Plani për energji dhe klimë në veçanti përmban:

1) pasqyrë të situatave rrjedhëse në sektorët energji dhe klimë, si dhe masat e ndërmarra për realizimin e politikës energjetike,

2) qëllimet kombëtare dhe trajektorja indikative për efikasitet energjetik, burime të ripërtërishme të energjisë, ulje të emisioneve të gazrave serrë, si dhe për tregun e energjisë, siguri në furnizimin me energji dhe hulumtime, inovacione dhe aftësi konkurruese,

3) masa të politikës energjetike për përmbushjen e qëllimeve kombëtare, sipas pikës 2) të këtij paragrafi, të bazuara në analizë të kufizimeve juridike, institucionale, ekonomike dhe sociale për realizimin e tyre,

4) skenari fillestar dhe skenari me plotësim të qëllimeve kombëtare nëpërmjet zbatimit të masave, dhe

5) pasqyrë e investimeve të nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të politikës energjetike dhe klimatike.

(3) Plani i miratuar për energji dhe klimë publikohet në Gazetën zyrtare të Republikës Maqedonisë së Veriut, në ueb faqen e Qeverisë dhe Ministrisë dhe i dorëzohet Sekretariatit të Bashkësisë Energjetike.

(4) Ministria, në bashkëpunim me Ministrinë kompetente për punët nga fusha e mjedisit jetësor, e ndjekë realizimin e Planit për energji dhe klimë dhe çdo dy vjet përgatitë raport për realizimin për dy vitet paraprake kalendarike që e dorëzon në Qeveri dhe në Sekretariatit e Bashkësisë Energjetike më së voni deri më 30 nëntor.

(5) Nëse nga raporti, sipas paragrafit (4), rezulton se përmbushja e qëllimeve nga Plani për energji dhe klimë nuk është në përputhje me dinamikën e trajektores indikative, Qeveria deri më 31 mars të vitit të radhës aprovon Plan të reviduar për energji dhe klimë dhe ia dorëzon Sekretariatit të Bashkësisë Energjetike. Në Planin e reviduar për energji dhe klimë përcaktohen masa me të cilat mundësohet realizim i qëllimeve kombëtare dhe trajektoreve indikative.

(6) Qeveria e njofton menjëherë Sekretariatit e Bashkësisë Energjetike në raste kur për shkak të rrethanave të paparashikuara në sektorin energjetik dhe sektorët që ndikojnë në ndryshimet klimatike nuk është i mundur realizimi i qëllimeve të përcaktuara në Planin për energji dhe klimë.“.

Neni 52

Pas nenit 172 shtohen dy tituj të rinj dhe dy nene të reja 172-a dhe 172-b, siç vijon:

**„Plan indikativ për ndërtimin e kapaciteteve prodhuese nga burimet e ripërtërishme të energjisë**

Neni 172-a

(1) Në bazë të planit të aprovuar për zhvillimin e sistemit për transmetimin e energjisë elektrike dhe planit për zhvillimin e sistemit për shpërndarje të energjisë elektrike, si dhe të dhënave që janë marrë nga institucionet kompetente, sipas paragrafit (4) të këtij neni, Qeveria, me propozim të Ministrisë, çdo vit miraton Plan indikativ për ndërtimin e kapaciteteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë (në tekstin e mëtejshëm: “Plan indikativ”).

(2) Qeveria, deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës, e miraton Planin indikativ për vitin e radhës, me projeksion për dy vitet e radhës.

(3) Plani indikativ në veçanti përmban:

1) Teknologjitë për prodhimin e energjisë elektrike për të cilat procedura për ndërtim mund të fillojë në periudhën me të cilën ka të bëjë Plani indikativ,

2) Fuqia e përgjithshme e instaluar, sipas rajoneve, që mund t’i bashkëngjitet sistemit për transmetim elektronik, respektivisht sistemit për shpërndarje elektronike, dhe

3) Raport për realizimin e Planit indikativ për vitin paraprak.

(4) Për nevojat e përpilimit të Planit indikativ, me kërkesë të Ministrisë, më së voni deri më 31 tetor të vitit rrjedhës, të dhëna dorëzojnë Komisioni Rregullator i Energjetikës, ministria kompetente për ushtrimin e punëve nga fusha e bujqësisë, ministria kompetente për ushtrimin e punëve nga fusha e mjedisit jetësor, Agjencia e Energjetikës dhe Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Ministri me rregullore i përcakton:

1) formën dhe përmbajtjen e Planit indikativ,

2) formën dhe përmbajtjen e raportit për realizimin e Planit indikativ për vitin paraprak,

3) të dhënat e nevojshme për përpilimin e Planit indikativ, si dhe mënyrën dhe afatet për dorëzimin e tyre nga institucionet, sipas paragrafit (6) të këtij neni.

**Pëlqim për ndërtimin e elektrocentraleve fotovoltaike**

Neni 172-b

(1) Organi i administratës shtetërore ose i njësisë së vetëqeverisjes lokale, si dhe personi fizik ose juridik, në Ministrinë dorëzon kërkesë për lëshimin e pëlqimit për ndërtimin e elektrocentralit fotovoltaiik në truall të parashikuar për ndërtim në procedurë të rregulluar me ligj.

(2) Me kërkesën, sipas paragrafit (1) të këtij neni, në të cilin janë përfshirë të dhëna për kapacitetin e instaluar në elektrocentralin fotovoltaiik ndërtimi i së cilës parashikohet, parashtrohen dëshmitë dhe të dhënat si vijon:

1) dokument identifikimi për person fizik ose gjendje rrjedhëse për person juridik;

2) elaborat gjeodezik për punë gjeodezike për dedikime të veçanta – të dhëna numerike me të cilat janë përcaktuar të dhënat kadastrale me matje dhe kufij të saktë të truallit në të cilin është parashikuar ndërtimi i elektrocentraleve fotovoltaike ose certifikatë nga plani urbanistik për truallin në të cilin parashikohet ndërtimi i elektrocentraleve fotovoltaike dhe

3) certifikatë nga plani kadastral për parcelën kadastrale në të cilën parashikohet ndërtimi i elektrocentraleve fotovoltaike.

(3) Dëshmitë dhe të dhënat për përmbushjen e kushteve, sipas paragrafit (2) pika 1), 2) dhe 3) të këtij neni, me përjashtim të elaboratit gjeodezik, sipas pikës 2) të këtij neni, i furnizon personi i autorizuar zyrtar nga Ministria, i cili është i obliguar që në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit të kërkesës t'i kërkojë dëshmitë nga organi kompetent publik.

(4) Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik është i obliguar që dëshmitë e kërkuara, sipas paragrafit (3) të këtij neni, t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga pranimi i kërkesës.

(5) Në bazë të të dhënave nga Plani i miratuar indikativ, Ministria në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kërkesës së plotë, sipas paragrafit (1) të këtij neni:

1) miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit për ndërtim të elektrocentralit fotovoltaik me kapacitet të instaluar deri 10 MW në truall të parashikuar për ndërtim në procedure të rregulluar me ligj ose

2) miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës për ndërtimin e elektrocentralit fotovoltaik me kapacitet të instaluar deri 10 MW nëtrualltëparashikuarpërndërtimin e procedurësërregulluar me ligjose

3) i propozon Qeverisë të sjell vendim për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e elektrocentralit fotovoltaik me kapacitet të instaluar mbi 10 MW nëtruallin e parashikuarpërndërtimnë procedure tërregulluar me ligjose

4) i propozon Qeverisë të sjell vendim për refuzimin e kërkesës për ndërtimin e elektrocentralit fotovoltaik me fuqi të instaluar mbi 10 MW tëtruallitëparashikuarpërndërtimnë procedure tërregulluar me ligj.

(6) Aktvendimi, sipas paragrafit (5), pika 1), të këtij neni, shfuqizohet nëse në afat prej gjashtë muajve nga dita e miratimit të tij, personi të cilit i është dhënë pëlqimi, nuk i dorëzon në Ministrinë njoftimin për fillimin e ndërtimit dhe aprovimin përkatës të plotfuqishëm në bazë të të cilës aprovohet ndërtimi i elektrocentralit fotovoltaik.

(7) Vendimi, sipas paragrafit (5), pika 3) të këtij neni, shfuqizohet nëse në afat prej 18 muajve nga dita e miratimit të tij, personi të cilit i është dhënë pëlqimi, nuk i dorëzon në Ministri njoftimin për fillimin e ndërtimit dhe aprovimin përkatës të plotfuqishëm në bazë të të cilës aprovohet ndërtimi i elektrocentralit fotovoltaik.“

#### Neni 53

Në nenin 181, paragrafi (1) ndryshohet dhe bëhet:

„Instalim i kaldajave dhe sobave me biomasa, sistemevefotovoltaike, sistemeve termike diellore, sistemeve të cekëta gjeotermike dhe pompave termike ushtron instaluesi i cili, në bazë të trajnimit të ndjekur dhe provimit të dhënë dhe kërkesës së parashtruar, Ministria i ka dhënë licencë për instalues, që ka vlefshmëri prej pesë viteve.“

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) siç vijon:

„(2) Agjencia e Energjetikës, nëpërmjet thirrjes publike, bën zgjedhjen e personit juridik për zbatimin e trajnimeve për instalues për periudhë prej tre viteve, që i përmbushë kushtet në raport me:

1) numrin minimal të të punësuarve ose personave të angazhuar profesional dhe arsimimin e tyre dhe përvojën e punës,

2) hapësira për zbatimin e trajnimit,

3) pajisje e nevojshme teknike, dhe

4) metodologjia për organizimin e trajnimit.

Paragrafët (2) dhe (3) bëhen paragrafë (3) dhe (4).

Në paragrafin (4) i cili bëhet paragrafi (5), në pikën 3) lidhëza „dhe“ në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje.

Pas pikës 4) shtohen tri pikë të reja 5), 6) dhe 7) siç vijon:

„5) kushtet më të afërta të cilat duhet t'i plotësojnë personat juridikë që zbatojnë trajnime për instalues si dhe menyra e zgjedhjes së tyre;

6) procedura për dhënien e provimit, dhe

7) mënyra e vazhimit të rëndësisës së licencës.”

Pas paragrafit (5) shtohen katër paragrafë të rinj (6), (7), (8) dhe (9) siç vijon:

„(6) Provimi përbëhet nga pjesa me shkrim dhe gojë me punë praktike, me çka pjesën me shkrim nga provimi e zbaton teknikisht personi juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut i zgjedhur nga nga Qeveria në procedurë në përputhje me rregullat nga fusha për furnizime publike, derisa pjesën me gojë të provimit e zbaton komisioni që mund të numërojë së paku tre, e më së shumti pesë anëtarë nga rradha e të punësuarve dhe ekspert të jashtëm varësisht nga lloji dhe karakteristikat e pajisjes dhe mjeteve për burime të ripërtërishme të energjisë që e formon ministri.

(7) Kompensimet për pjesëmarrje në trajnimin për instalues, si dhe shpenzimet për dhënien e provimit janë në barrë të kandidatit për instalues dhe janë të hyra të Ministrisë.

(8) Anëtarëve të komisionit që e zbaton pjesën me gojë të provimit me punë praktike u takon kompensim për punën e kryer, që duhet të jetë adekuat me rëndësinë, vëllimin dhe kompleksitetin e punës dhe jo më i lartë se një e treta e pagës mesatare neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga viti paraprak, e shpallur nga Enti Shtetëror i Statistikës. Kompensimin e përcakton ministri, ndërsa mjetet sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(9) Lartësia e kompensimeve për pjesëmarrje në trajnimin për instalues, si dhe shpenzimet për dhënien e provimit përcaktohen sipas kushteve hapësinore dhe materiale për zbatimin e trajnimit, shpenzimet për angazhimin e personave profesionalë për zbatimin e trajnimeve dhe provimeve dhe shpenzimet tjera të nevojshme për zbatimin e trajnimit dhe përcaktohen me listën tarifore që e miraton ministri.“

#### Neni 54

Në nenin 182, në paragrafin (1) fjalët: „Agjencia e Energjetikës“ zëvendësohen me fjalët: „Operatori i Tregut të Energjisë Elektrike“, ndërsa fjala: „saj“ zëvendësohet me fjalën: „tij“.

Në paragrafin (2), fjalët: „Agjencia e Energjetikës“ zëvendësohen me fjalët: „Operatorii Tregut të Energjisë Elektrike“.

Paragrafi (4) ndryshohet dhe bëhet:

„Për lëshimin, bartjen ose njohjen e garancisë për origjinë, kërkuesi është i obliguar të paguajë kompensim në llogari të operatorit të tregut të energjisë elektrike, shuma e të cilit përcaktohet me listë tarifore që e miraton operatorii tregut të energjisë elektrike pas aprovimit paraprak nga Komisioni Rregullator i Energjetikës“.

Në paragrafin (5) fjalët: „rregullorja e miratuar në bazë të nenit 185 të këtij ligji“ zëvendësohen me fjalët: „urdhëresa sipas paragrafit (7) të këtij neni“.

Pas paragrafit (6) shtohen dy paragrafë të rinj (7) dhe (8) siç vijon:

„(7) Qeveria, me propozim të Ministrisë miraton urdhëresë për garanci për origjinë me të cilin më afër i rregullon:

1) mënyrën e lëshimit, bartjes, heqjes dhe anulimit të garancive për origjinë,

2) formën dhe përmbajtjen e garancive për origjinë,

3) mënyrën, procedurën dhe kushtet për njohjen e garancive për origjinë të lëshuara në shtete të tjera, dhe

4) përmbajtjen, formën dhe mënyrën e udhëheqjes së Regjistrit të garancive të origjinës.

(8) Operatorii tregut të energjisë elektrike miraton rregulla për administrimin e garancive për origjinë në përputhje me këtë ligj, urdhëresën, sipas paragrafit (7) të këtij neni, dhe standardet e asociacionit të trupave-lëshues të garancive për origjinë, me të cilat më afër i përcakton:



- 1) mënyrën e regjistrimit të shfrytëzuesit të Regjistrit të garancive për origjinë;
- 2) model marrëveshjen që lidhet mes operatorit të tregut të energjisë elektrike dhe shfrytëzuesit të Regjistrit të garancive të origjinës;
- 3) rregullat teknike për lëshimin, bartjen, heqjen dhe anulimin e garancive të origjinës, si dhe për udhëheqjen e Regjistrit të garancive të origjinës; dhe
- 4) publikim i të dhënave të karakterit publik“.

#### Neni 55

Në nenin 184, në paragrafin (1), pika 3) fshihet.

Pika 4) bëhet pika 3).

Në paragrafin (2), në pikën 2), presja dhe lidhëza “dhe” zëvendësohen me pikë.

Pika 3) fshihet.

#### Neni 56

Në nenin 185, pika 2) ndryshohet dhe bëhet:

„kushtet më të afërta që duhet t’i përmbushë konsumatori për t’u bërë konsumator-prodhues, në raport me mënyrën e furnizimit me energji elektrike, llojin dhe kapacitetin maksimal të instaluar të stabilimentit për prodhim dhe kushtet teknike për kyçje, procedura për lidhjen e kontratës mes konsumatorit-prodhues dhe furnizuesit me energji elektrike, mënyra e dorëzimit të të dhënave, evidentimit të kontratave të lidhura, mënyrën e dorëzimit dhe përlllogaritja e vlerës së tepicës së energjisë elektrike të prodhuar nga konsumatori-prodhues dhe e dorëzuar në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe periudha e përlllogaritjes dhe periudha e faturimit“.

Pikat 5) dhe 6) fshihen.

Në pikën 7), e cila bëhet pika 5), lidhëza „dhe“ në fund të fjalisë zëvendësohen me presje dhe shtohen fjalët: “elektrocentralet të cilat duhet të regjistrohen në regjistër, si dhe procedura për regjistrim në regjistër.”.

Pika 8) fshihet.

#### Neni 57

Pas nenit 185 shtohet titull i ri dhe neni i ri 185-a, siç vijon:

### **„Detyrim për regjistrim në Regjistrin e elektrocentraleve**

#### Neni 185-a

Prodhuesit e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë janë të detyruar t’i regjistrojnë elektrocentralet e përcaktuara me rregulloren, sipas nenit 185 të këtij ligji, në regjistrin e elektrocentraleve që prodhojnë energji elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë.“.

#### Neni 58

Në nenin 186, paragrafi (1), fjalët „Plan veprimi për burime të ripërtërishme të energjisë“ zëvendësohen me fjalët „Plani për energji dhe klimë“.

Në paragrafin (2), në pikën 7), lidhëza “dhe” në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 8), pika në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje.

Pas pikës 8) shtohen dy pika të reja 9) dhe 10) siç vijon:

„9) ndarja e së drejtës për shfrytëzimin e truallit në pronësi shtetërore që është parashikuar për ndërtimin e elektrocentraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme, me procedurë të rregulluar me ligj, dhe

10) sigurim të blerjes së garantuar të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme“.

#### Neni 59

Në nenin 187, paragrafi (3), në pikën 9) lidhëza “dhe” zëvendësohet me “pikëpresje”.

Në pikën 10), pika në fund të fjalisë fshihet dhe shtohen fjalët „dhe masa të tjera për mbështetje, dhe“.

Pas pikës 10) shtohet pika e re 11) siç vijon:

„11) për masat tjera për mbështetje: llojet e teknologjive për të cilat ndahen, kushtet që duhet t’i përmbushë elektrocentrali, përmbajtja e vendimit dhe shpalljes publike dhe mënyra e zbatimit të procedurës së tenderimit për ndarjen e tyre, periudha e shfrytëzimit, mënyrë e përcaktimit të vlerës dhe/ose vlerës së masave të tjera për mbështetje, si dhe elementet e detyrueshme të kontratës për shfrytëzimin e masave“.

Në paragrafin (4) fjalët „Plani i veprimit për burime të ripërtërishme të energjisë“ zëvendësohen me fjalët “Plani për energji dhe klimë”.

#### Neni 60

Në nenin 188, pas paragrafit (3) shtohen tre paragrafë të rinj (4), (5) dhe (6) siç vijon:

„(4) Komisioni, sipas paragrafit (2), pika 2) të këtij neni, është i përbërë prej tre anëtarëve dhe zëvendësve të tyre edhe atë dy persona dhe zëvendësit e tyre radhët e të punësuarve në Ministrinë dhe një person dhe zëvendësi i tij i përcaktuar nga Qeveria. Kryetar i Komisionit është përfaqësuesi nga Ministria.

(5) Anëtarët e Komisionit, sipas paragrafit (2) pika 2) të këtij neni duhet të kenë së paku 240 kredi sipas EKTS ose shkallën e mbaruar VII/ dhe së paku tre vite përvojë pune në fushën e energjetikës dhe/ose furnizimeve publike.

(6) Anëtarëve të Komisionit, sipas paragrafit (2) pika 2) të këtij neni, u takon kompensim mujor për punën e ushtruar, që duhet të jetë adekuat me vëllimin dhe kompleksitetin e punës, dhe jo më i lartë se një e treta e pagës mesatare neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin paraprak e publikuar nga Entit Shtetëror i Statistikës dhe paguhet për muajt në të cilët zbatohet procedura e tenderimit. Kompensimin e përcakton ministri, ndërsa mjetet sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Paragrafët (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10), (11) dhe (12), bëhen paragrafë (7), (8), (9), (10), (11), (12), (13), (14) dhe (15).

#### Neni 61

Në nenin 191, paragrafi (1), pas pikës 3) shtohet pikë e re 4) siç vijon:

„4) mënyra dhe procedura për ndërprerjen e aktvendimit për përvetësimin e statusit të përkohshëm të prodhuesit preferencial, respektivisht statusin e prodhuesit preferencial dhe për ndërprerjen e vendimit për shfrytëzimin e tarifës preferenciale.“

Pikat 4), 5) dhe 6) bëhen pika 5), 6) dhe 7).

Pas paragrafit (5) shtohen dy paragrafë të rinj (6) dhe (7) siç vijon:

„(6) Komisioni Rregullator i Energjetikës sipas detyrës zyrtare e vazhdon vlefshmërinë e aktvendimit për marrjen e statusit të përkohshëm të prodhuesit të autorizuar nëse prodhuesit preferencial i është lëshuar licenca për ushtrimin e veprimtarisë energjetike prodhimtari të energji elektrike, deri në miratimin e aktvendimit për marrjen e statusit të prodhuesit preferencial dhe vendim për përdorimin e tarifës preferenciale të energjisë elektrike në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara në rregullore, sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(7) Bartësi i aktvendimit për përvetësimin e statusit të përkohshëm të prodhuesit preferencial është i obliguar që në Komisionin Rregullator i Energjetikës të dorëzojë dëshmi për njoftim të parashtruar për fillimin e ndërtimit të elektrocentralit në përputhje me rregullat nga fusha e ndërtimit“.

Paragrafi (6), i cili bëhet paragrafi (8), ndryshohet dhe bëhet:

„(8) Komisioni Rregullator i Energjetikës miraton aktvendim për pushimin e aktvendimit për marrjen e statusit të përkohshëm të prodhuesit të autorizuar dhe e fshin elektrocentralin nga Regjistri i prodhuesve preferencial që përdorin tarifë preferenciale, nëse:

- nëse bartësi i aktvendimit për marrjen e statusit të përkohshëm të prodhuesit preferencial nuk ka filluar ndërtimin në afatin e përcaktuar me rregullat nga fusha e ndërtimit ose

- elektrocentrali nuk është lëshuar në përdorim në afatet e përcaktuara me aktvendimin sipas paragrafëve (4) dhe (5) të këtij neni.“

Paragrafët (7), (8) dhe (9) bëhen paragrafë (9), (10) dhe (11).

Pas paragrafit (10), i cili bëhet paragrafi (12), shtohen dy paragrafë të rinj (13) dhe (14) siç vijon:

„(13) Statusi i prodhuesit preferencial dhe e drejta e përdorimit të tarifës preferenciale mund të barten te person tjetër të cilit i është bartur licenca për ushtrimin e veprimtarisë prodhim i energjisë elektrike në përputhje me nenin 39 të këtij ligji.

(14) Bartësi i aktvendimit, sipas paragrafëve (4) dhe (12) është i obliguar ta njoftojë Komisionin Rregullator të Energjetikës për ndryshimet e ndodhura në afate dhe në mënyrë të përcaktuar në rregullën, sipas paragrafit (1) të këtij neni“.

Në paragrafin (11), i cili bëhet paragrafi (15), fjalët „(6) dhe (10)“ zëvendësohen me fjalët „(8) dhe (12)“.

#### Neni 62

Në nenin 192, paragrafi (1) ndryshohet dhe bëhet:

„Prodhuesi preferencial i cili shfrytëzon tarifë preferenciale, krahas detyrimeve sipas nenit 70 të këtij ligji, në përputhje me marrëveshjen për blerje të energjisë elektrike sipas nenit 193 paragrafi (2) të këtij ligji, është i obliguar t’ia shesë energjinë e prodhuar elektrike vetëm operatorit në tregun e energjisë elektrike.“.

#### Neni 63

Në nenin 193, në paragrafin (8) fjalët: „dhe/ose tregtarë“ fshihen.

#### Neni 64

Pas nenit 194 shtohen titull i ri dhe neni i ri 194-a, siç vijon:

### **„Konsumator-prodhues**

#### Neni 194-a

(1) Konsumatori i energjisë elektrike i cili i përmbushë kushtet nga rregullorja sipas nenit 185 të këtij ligji mund të ndërtojë stabiliment për prodhimin dhe magazinimin e energjisë elektrike nga burimi i ripërtërishëm i energjisë, me çka energjia e prodhuar elektrike ta shfrytëzojë për konsumin personal, ndërsa tepricën e energjisë së prodhuar elektrike t’ia dorëzojë rrjetit për shpërndarjen e energjisë elektrike (në tekstin e mëtejshëm: konsumator-prodhues).

(2) Me kërkesë të konsumatorit-prodhues, furnizuesi i cili e furnizon me energji elektrike është i obliguar të lidhë kontratë për furnizim me energji elektrike dhe dorëzimin e tepricës së energjisë së prodhuar elektrike në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe të mbajë evidencë dhe të sigurojë të dhëna për kontratat e lidhura.

(3) Agjencia e Energjetikës ushtron funksionin si pikë e kontaktit për konsumator-prodhues, siguron informacione dhe këshilla për të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit-prodhues dhe furnizuesit.”.

#### Neni 65

Në nenin 195, në paragrafin (1), pika 6) fshihet.  
Pika 7) bëhet pika 6).

#### Neni 66

Në nenin 199, në paragrafin (1), pas fjalës: „kanë“ shtohen fjalët: „arsim përkatës profesional dhe përvojë praktike, në përputhje me paragrafin (9) të këtij neni, si dhe”, ndërsa para pikes vendoset presje dhe shtohen fjalët: „që përmban pjesën me shkrim dhe pjesën me gojë me punë praktike“.

Paragrafi (2) ndryshohet dhe bëhet:

„Pjesën me shkrim të provimit teknikisht e zbaton personi juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut i zgjedhur nga Qeveria në procedurë në përputhje me rregullat për furnizime publike“.

Paragrafi (3) ndryshohet dhe bëhet:

„Pjesën e provimit me gojë me punë praktike e zbaton komisioni prej së paku pesë, e më së shumti nëntë anëtarë nga radhët e të punësuarve në Ministrinë dhe persona të jashtë profesional, varësisht nga lloji dhe karakteristikat e pajisjeve dhe stabilimenteve energjetike, që e formon ministri. Anëtarëve të komisionit u takon kompensim në para për punën e kryer që në nivel vjetor nuk e tejkalon nivelin e tri pagave mesatare mujore neto të paguara në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës.

Në paragrafin (5) fjala: „shpenzimet“ zëvendësohet me fjalën: „kompensimet“, ndërsa fjala „paguajnë“ zëvendësohet me fjalën „pagan“

Në paragrafin (6) fjalët: “shpenzimet nuk janë të paguara” zëvendësohen me fjalët: “kompenzimi nuk është paguar”

Pas paragrafit (9), në pikën 17), fjala „katërvjeçare“ zëvendësohet me fjalën „trevjeçare“.

Pas paragrafit (9) shtohen tre paragrafë të rinj (10), (11) dhe (12) siç vijon:

„(10) Për personin që operon qendrat dispeçere dhe elektrokomandat në operatorë të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe i përmbushë kushtet, sipas paragrafit (9), pika 17) të këtij neni, trajnimi, dhënia e provimit dhe certifikimi bëhet në përputhje me rregullat dhe dokumentet shoqëruese të ENTSO-E.

(11) Ministria mban evidencë për provimet e zbatuara.

(12) Ministri me rregullore më afër i përcakton:

- programin për provimin,
- kushtet që secili anëtar i Komisionit duhet t’i përmbushë, si dhe detyrat e tij,
- mënyrën e përpilimit dhe revidimit të pyetjeve nga provimi, si dhe personave që i përpilojnë dhe revidojnë,
- procedurën për dhënien e provimit,
- mënyrën e përdorimit të sistemit elektronik për dhënien e pjesës me shkrim të provimit,
- kushtet teknike për hapësirën në të cilën jepet pjesa me shkrim i provimit,
- kushtet për ndërprerje dhe vazhdim të dhënies së provimit,
- përmbajtja, mënyra dhe afati i përpilimit të procesverbalit dhe raportit nga dhënia e provimit,
- forma dhe përmbajtja e certifikatës për provim të dhënë, dhe
- përmbajtja dhe mënyra e udhëheqjes së evidencës nga provimet e zbatuara, si dhe afatet për ruajtjen e saj.”.

#### Neni 67

Në nenin 206, pas paragrafit (5) shtohen dy paragrafë të rinj (6) dhe (7) siç vijon:

„(6) Komisioni Rregullator i Energjetikës ushtron mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave nga ky ligj që kanë të bëjnë me sigurimin e integritetit dhe transparencës, respektivisht ndalimin për tregti të bazuar në informacione të brendshme dhe ndalimin e manipulimit të tregut dhe/ose tentim për manipulim të tregjeve të produkteve energjetike me shumicë.

(7) Komisioni Rregullator i Energjetikës ushtron mbikëqyrje mbi punën e bartësve të licencave në raport me përmbushjen e detyrimeve të tyre të përcaktuara në licencat e lëshuara.“

Paragrafi (6) bëhet paragrafi (8).

#### Neni 68

Pas nenit 208 shtohet neni i ri 208-a, siç vijon:

##### „Neni 208-a

(1) Mbikëqyrjen, sipas nenit 206 paragrafët (4), (5), (6) dhe (7) të këtij ligji, e ushtrojnë të punësuarit në shërbimin profesional, të përcaktuar me aktin e sistematizimit të vendeve të punës të Komisionit Rregullator të Energjetikës (në tekstin e mëtejshëm: persona të autorizuar).

(2) Mbikëqyrja, sipas paragrafit (1) të këtij neni, ushtrohet si:

1) Mbikëqyrje të rregullt, që ushtrohet në përputhje me planin vjetor për ushtrimin e mbikëqyrjes që e miraton Komisionin Rregullator i Energjetikës më së voni deri më 31 dhjetor të vitit për vitin e radhës, dhe

2) Mbikëqyrje të jashtme, e cila ushtrohet pas iniciativës së parashtruar nga organi shtetëror, njësia e vetëqeverisjes lokale, pjesëmarrës në tregun përkatës të energjisë ose person tjetër juridik ose fizik.

(3) Për ushtrimin e mbikëqyrjes, sipas paragrafit (2) të këtij neni, Komisioni Rregullator i Energjetikës miraton aktvendim në të cilin përcaktohet arsyeja për ushtrimin e mbikëqyrjes, personit në të cilin ushtrohet mbikëqyrja, personat e autorizuar, kohëzgjatja dhe fushëveprimi i mbikëqyrjes.

(4) Komisioni Rregullator i Energjetikës së paku një ditë para fillimit të ushtrimit të mbikëqyrjes e dorëzon aktvendimin, sipas paragrafit (3) të këtij nen, ideri te personi që ushtron mbikëqyrjen, përveç nëse me aktvendimin është përcaktuar se me dorëzimin do të ishte zvogëluar efikasiteti i mbikëqyrjes.

(5) Personi mbi të cilin ushtrohet mbikëqyrja është i obliguar personat të autorizuar t'u mundësojë ushtrim të papenguar të mbikëqyrjes, e veçanërisht të përgatisë dhe të vendosë për shqyrtim pika dhe të dhëna të plota, raporte, dokumente, materiale ose dokumente të tjera që janë të domosdoshme për ushtrimin e mbikëqyrjes, të japë informacione me gojë në formë të deklaratave ose përgjigjeve, të mundësojë qasje deri te hapësirat, stabilimentet, produktet energjetike, dokumentet ose çfarë mjeti tjetër lidhur me objektin e mbikëqyrjes.

(6) Për veprimet e ndërmarra gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes përpilon procesverbal të cilin e nënshkruajnë personat e autorizuar dhe personat përgjegjës në personin në të cilin është ushtruar mbikëqyrja dhe në afat prej tre ditëve nga veprimet e ndërmarra i dorëzohet subjektit të mbikëqyrjes.

(7) Në afat prej 60 ditësh pas përfundimit të mbikëqyrjes, personat e autorizuar deri te anëtarët e Komisionit Rregullator të Energjetikës dorëzojnë raport për mbikëqyrjen e ushtruar.

(8) Krahas zbatimit të mbikëqyrjes në mënyrën e përcaktuar me dispozitat të këtij neni, Komisioni rregullator për energjetikë e ushtron mbikëqyrjen mbi pjesëmarrësit në tregjet e energjisë me shumicë me produkte energjetike sipas nenit 25-a të këtij ligji nëpërmjet hulumtimit që përfshin shqyrtimin dhe kontrollin e veprimeve të palejueshme, sipas nenit 25-a të këtij ligji.

(9) Komisioni Rregullator i Energjetikës miraton rregullore për ushtrimin e mbikëqyrjes, me të cilën më afër rregullohen përgatitjet dhe zbatimi i mbikëqyrjes.”

## Neni 69

Neni 210 ndryshohet dhe bëhet:

„Kryetari i Këshillit inspektues lëshon urdhër për ushtrimin e mbikëqyrjes së përbashkët të jashtëzakonshme inspektuese nga organet e inspektimit, sipas nenit 209 të këtij ligji, në përputhje me ligjin me të cilin rregullohet mbikëqyrja inspektuese.“.

## Neni 70

Neni 212 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes inspektues inspektori nga Inspektorati Shtetëror i Inspektimit Teknik përcakton se nuk u përmbahet ose në mënyrë joadekuate u përmbahet dispozitave të këtij dhe ndonjë ligji tjetër, rregulloreve, rregullave, standardeve, specifikave dhe normave të tjera të cilësisë miraton aktvendim me të cilin shqipton paralajmërim në të cilin e përcakton afati në të cilin subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i obliguar t’i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë, të përcaktuara me procesverbal.

(2) Me përjashtim, sipas paragrafit (1) të këtij neni, në rast se inspektori vlerëson se parregullsitë dhe mangësitë e përcaktuara mund të shkaktojnë ose shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejt ndaj jetës dhe shëndetit të njerëzve ose dëm financiar ose dëm ndaj pasurisë me vlerë më të madhe ose rrezikim të mjedisit jetësor ose rrezikim të interesit publik, miraton aktvendim me të cilin:

1) ndalon përdorimin e objektit, stabilimentit, pajisjes ose instalacionit, dhe

2) ndalon përdorimin, respektivisht ndërtimin dhe realizimin e objektit, stabilimentit, pajisjes ose instalacionit.

(3) Nëse pas kalimit të afatit të përcaktuar gjatë shqiptimit të paralajmërimit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, inspektori përcakton se parregullsitë dhe mangësitë ende nuk janë mënjeluar, miraton aktvendim me të cilin shqipton masë inspektuese, sipas paragrafit (2) në këtë nen.

(4) Për aktvendimin e miratuar, sipas paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni, që ka të bëjë me bartësin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë energjetike inspektori është i obliguar ta njoftojë Komisionin Rregullator të Energjetikës.

(5) Nëse ushtruesi i veprimtarisë energjetike nuk vepron në përputhje me aktvendimin, sipas paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni, inspektori nga Inspektorati Shtetëror i Inspektimit Teknik parashtron kërkesë për nisjen e procedurës kundërvajtëse.

(6) Inspektorati Shtetëror i Inspektimit Teknik vendos dhe mba evidencë të paralajmërimeve të shqiptuara, sipas paragrafit (1).“.

## Neni 71

Neni 213 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese Inspektorati Shtetëror i Tregut përcakton se nuk u është përmbajtur ose në mënyrë joadekuate u janë përmbajtju rregullave me të cilat rregullohet furnizimi i konsumatorëve me energji, respektivisht pjesëmarrësit në tregun e karburanteve të lëngshme nuk u përmbahen detyrimeve të përcaktuara me rregullën, sipas nenit 150, paragrafi (1) të këtij ligji, miraton aktvendim me të cilin shqipton paralajmërim në të cilin përcakton afat në të cilin subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i obliguar t’i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë, të përcaktuar me procesverbal.

(2) Me përjashtim, sipas paragrafit (1) të këtij neni, në rast se inspektori vlerëson se parregullsitë dhe mangësitë e përcaktuara mund të shkaktojnë ose shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejt ndaj jetës dhe shëndetit të njerëzve ose dëm financiar ose dëm ndaj pasurisë me vlerë më të madhe ose rrezikim të mjedisit jetësor ose rrezikim të interesit publik, miraton aktvendim me të cilin urdhëron që të tërhiqen nga qarkullimio karburantet e lëngshme cilësia e të cilëve nuk përkon me atë që është përcaktuar.

(3) Nëse pas skadimit të afatit të përcaktuar gjatë shqiptimit të paralajmërimit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, inspektori përcakton se parregullsitë dhe mangësit ende nuk janë mënjeluar, miraton aktvendim me të cilin shqipton masë inspektuese, sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Për aktvendimin e miratuar, sipas paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni, që ka të bëjë me bartësin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë energjetike inspektori është i obliguar ta njoftojë Komisionin Rregullator të Energjetikës.

(5) Nëse ushtruesi i veprimtarisë energjetike nuk vepron në përputhje me aktvendimin, sipas paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni, inspektori nga Inspektorati Shtetëror i Tregut parashtron kërkesë për nisjen e procedurës kundërvajtëse.

(6) Inspektorati Shtetëror i Tregut vendosë dhe mba evidencë të paralajmërimeve të shqiptuara, sipas paragrafit (1) të këtij neni.“.

#### Neni 72

Në nenin 214, në paragrafin (2,) pas numrit „230“ shtohet presje dhe fjalët: „neni 231, paragrafi (1), pika 2)“, ndërsa pas numrit „232“ shtohen fjalët „si dhe sipas neneve 217, 228 dhe 231 për të cilat është parashikuar gjobë në vlerë prej 1000euro në kundërvlerë denari për person juridik, mbi 500 euro në kundërvlerë denari për person përgjegjës në personin juridik dhe mbi 250 euro në kundërvlerë denari për person fizik.“.

#### Neni 73

Në nenin 215, në paragrafin (2) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Për udhëheqjen e procedurës kundërvajtëse dhe shqiptimin e sanksionit kundërvajtës për kundërvajtjet, sipas paragrafit (1) të këtij neni, për të cilat është parashikuar gjobë në vlerë deri 1 000 euro në kundërvlerë denari për person juridik, 500 euro në kundërvlerë denari për person përgjegjës në personin juridik dhe 250 euro në kundërvlerë denari për person fizik, ministrin me aktvendim formon komision për vendimmarrja ndaj kundërvajtjes (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për kundërvajtje), i përbërë nga tre anëtarë nga radhët e personave të punësuar në Ministrinë, edhe atë:“.

Paragrafi (8) ndryshohet dhe bëhet:

„Kundër aktvendimeve të Komisionit për kundërvajtje mund të deklarohet mjet juridik në organin kompetent në përputhje me Ligjin e Kundërvajtjes“.

Paragrafi (9) fshihet.

#### Neni 74

Në nenin 216, në paragrafin (2), pas fjalëve “nisje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtjet” shtohen fjalët „sipas neneve 217, 218 paragrafët (2), (4), (5), (6) dhe (7), 219, 220 paragrafët (2), (3), (4) dhe (5), 221, 222 paragrafët (2), (3), (4) dhe (5), 223paragrafët (1), (2), (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10), (11) dhe (12), 224 paragrafët (2), (3), (4) dhe (5), 225, 226 paragrafët (2), (3) dhe (4), 231 dhe 232“.

Paragrafi (4) ndryshohet dhe bëhet:

„Në procedurën për rrafshimin e gjobës në fletëpagesën për kundërvajtje shqiptohet vlera minimale e përcaktuar për kundërvajtjen.“.

#### Neni 75

Në nenin 217, paragrafi (1), fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 100 euro deri 300 euronëkundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si mikro tregtar, gjobë në vlerë prej 300 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i

vogël, gjobë në vlerë prej 500 euro deri 1 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i madhe dhe gjobë në vlerë prej 1 000 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i madh.“

Paragrafi (2) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 100 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë e klasifikuar si mikro tregtar, gjobë në shumë prej 150 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë e klasifikuar si në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë e klasifikuar si tregtar i vogël dhe i mesëm dhe gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë e klasifikuar si tregtar i madhe, për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (1) të këtij neni.“

#### Neni 76

Në nenin 218, paragrafi (1) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë deri 10% të të ardhurave të përgjithshme të personit juridik të realizuara në vitin paraprak fiskal në veprimtarinë energjetike për ushtrimin e të cilës ka marrë licencë nga Komisioni Rregullator i Energjetikës do t'i shqiptohet për kundërvajtje:

1) ushtrues i veprimtarisë energjetike, sipas nenit 24, paragrafi (2), nëse nuk e shpall aktin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

2) pjesëmarrës në tregjet me shumicë, sipas nenit 25-a, paragrafi (4), për tregtim bazuar në informacione të brendshme në tregun me shumicë të energjisë elektrike dhe gazit natyror (neni 25-a, paragrafi (1))

3) pjesëmarrës në tregjet me shumicë, sipas nenit 25-a, paragrafi (4), për manipulimin e tregut me shumicë të energjisë elektrike dhe gazit natyror (neni 25-a, paragrafi (2))

4) pjesëmarrës në tregjet me shumicë, sipas nenit 25-a, paragrafi (4), për tentim për manipulim të tregut me shumicë të energjisë elektrike dhe gazit natyror (neni 25-a, paragrafi (3))

5) pjesëmarrës në tregjet me shumicë, sipas nenit 25-a, paragrafi (4) të këtij ligji, nëse nuk dorëzon raporte në Komisionin Rregullator të Energjetikës ose nëse nuk publikon informacione të plota dhe të saktë të brendshme (neni 25-a, paragrafi (6))

6) ushtrues i veprimtarisë energjetike nëse nuk dorëzon në Komisionin Rregullator të Energjetikës raport vjetor, sipas nenit 28, paragrafi (6)

7) ushtrues i veprimtarisë energjetike i cili ka kërkuar ndërprerje ose të cilit i është marrë licenca, nuk vazhdon me sigurimin e shërbimit publik, respektivisht universal në përputhje me masat për sigurimin e shërbimit publik, respektivisht universal dhe/ose nuk i zbaton çmimet dhe tarifatat e vlefshme (neni 51, paragrafi (4))“

Në paragrafin (2) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 700 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si mikro tregtar, gjobë në vlerë prej 1 500 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë në vlerë prej 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtari madh, që:“

Në pikën 3) fjalët „fillon me ushtrimin e“ zëvendësohen me fjalën „ushtron“.

Pas pikës 3 shtohet pika e re 4) siç vijon:

„që nuk i përmbushë detyrimet e tij të përcaktuara në licencën e lëshuar për ushtrimin e veprimtarisë energjetike, e për të cilat është përcaktuar sanksion i veçantë në dispozitat tjera për kundërvajtje të këtij ligji“.



Në paragrafin (3) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet: „Gjobë në vlerë prej 1% të të ardhurave të përgjithshme të personit juridik të realizuara në vitin paraprak fiskal në veprimtarinë energjetike për ushtrimin e të cilës ka marrë licencë nga Komisioni Rregullator i Energjetikës do t’i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë:“.

Pas pikës 2) shtohen pesë pika të reja 3), 4), 5), 6) dhe 7) siç vijon:

„3) pjesëmarrës në tregjet me shumicë, sipas nenit 25-a, paragrafi (4), nëse nuk parashtrohet kërkesë për regjistrim në evidencën që e vendosë dhe udhëheqë Komisioni Rregullator i Energjetikës (neni 25-a, paragrafi (5)),

4) që në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së vet ndërmjetëson në kontraktimin e transaksioneve me produkte energjetike në tregjet ka dyshim të bazuar se transaksioni i caltuar mund të paraqesë tregtim bazuar në informacione të brendshme, manipulim të tregut ose tentim për manipulim të tregut për atë nuk e ja njoftuar Komisionin Rregullator të Energjetikës (neni 25-a, paragrafi (7)),

5) që nuk ka vendosur dhe nuk u përmbahet mekanizmave efikasë për dallimin e tregtisë bazuar në informacione të brendshme, manipulim të tregut ose tentim për manipulim të tregut (neni 25-a, paragrafi (8)),

6) operatorët e sistemit për transmetim të energjisë elektrike dhe për shpërndarje të energjisë elektrike dhe prodhuesit e energjisë elektrike të cilët menaxhojnë elektrocentrale me kapacitet të përgjithshëm të instaluar të barabartë ose më të madh se 200 MW, nëse nuk i zbatojnë masat dhe aktivitetet për sajber siguri (neni 30-a, paragrafët (1) dhe (2)),

7) bartësi i licencës për ushtrimin e veprimtarisë energjetik nuk dorëzon raport vjetor në Komisionin Rregullator të Energjetikës (neni 38, paragrafi (10)).“

Pikat 3) dhe 4) bëhen pika 8) dhe 9).

Pas paragrafit (3) shtohen tre paragrafëtë rinj (4), (5) dhe (6) siç vijon:

„(4) Gjobë në vlerëderi 5 000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqëri.

(5) Gjobë në vlerë prej 2 500 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik për tregtim bazuar në informacione të brendshme, manipulim të tregjeve me shumicë të energjisë elektrike dhe gazit natyror, respektivisht tentim për manipulim të tregjeve me shumicë të energjisë elektrike dhe gazit natyror (neni 25-a, paragrafët (1), (2) dhe (3))“.

(6) Gjobë në vlerë prej 1 500 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik për veprimet sipas paragrafit (3), pikat 4) dhe 5) të këtij neni“.

Paragrafi (4), i cili mbetet paragrafi (7), ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 100 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në shoqërinë e klasifikuar si mikro tregtar, gjobë në vlerë prej 300 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në shoqërinë e klasifikuar si tregtar i vogël dhe i mesëm dhe gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në shoqërinë e klasifikuar si tregtar i madh, për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni“.

Paragrafi (5), i cili bëhet paragrafi (8), ndryshohet dhe bëhet:

„(8) Për kundërvajtje, sipas paragrafit (2) dhe paragrafi (3) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë mund t’i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalesë për ushtrimin e detyrës në kohëzgjatje deri gjashtë muaj“.

Pas paragrafit (8) shtohet paragrafi i ri (9) siç vijon:

„(9) Krahas gjobës, sipas paragrafit (1) të këtij neni, pjesëmarrësit në tregjet me shumicë, sipas nenit 25-a, paragrafi (4) të këtij ligji, mund t’i shqiptohet sanksion kundërvajtës me ndalim të ushtrimit të veprimtarisë në kohëzgjatje prej dy vitesh për kundërvajtje për veprimet, sipas nenit 25-a paragrafët (1), (2) dhe (3).“.

#### Neni 77

Në nenin 219, në paragrafin (1), fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë ose personit tjetër juridik prodhues i energjisë elektrike do t’i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari nëse është i klasifikuar si mikrotregtar, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 500 euro deri 1000 euro në kundërvlerë denari nëse është i klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1 500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është i klasifikuar sisi tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është i klasifikuar sitregtar i madh, që:“.

Paragrafi (2) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 100 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë, respektivisht person tjetër juridik që është klasifikuar simikro tregtar, gjobë në vlerë prej 150 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë, respektivisht person tjetër juridik që është klasifikuar sitregtar i vogël ose i mesëm dhe gjobë në vlerë prej 250 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë, respektivisht person tjetër juridik që është klasifikuar sitregtar i madh, për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (1) të këtij neni”.

#### Neni 78

Në nenin 220, në paragrafin (1) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë deri 10% të të ardhurave të përgjithshme të personit juridik të realizuara në vitin paraprak fiskal në veprimtarinë energjetike për ushtrimin e të cilës ka marrë licencë nga Komisioni Rregullator i Energjetikës do t’i shqiptohet për kundërvajtje operatorit të sistemit për transmetimin e energjisë elektrike nëse:“.

Në paragrafin (1) shtohet pikë e re 1) siç vijon:

„1) stabilimentin për magazinimin e energjisë elektrike e shfrytëzon për sigurimin e shërbimeve për balancim ose menaxhim të ngulfatjeve (neni 70-a paragrafi (2)).“

Pikat (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) bëhen pika (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8) dhe (9).

Në paragrafin (2) në fjalinë hyrëse fjalët „nga 10 000 euro“ zëvendësohen me fjalët: „nga 7 000 euro deri 10 000euro“.

Në paragrafin (2), në pikën 3), fshihen fjalët: „dhe grupe balancimi“.

Në paragrafin (2) shtohen dy pika të reja 12) dhe 13) siç vijon:

„12) nuk miratoi dhe publikon në ueb faqen e vet rregulla për formën, përmbajtjen dhe dinamikën e dorëzimit dhe publikimit të të dhënave (neni 82, paragrafi (6));

13) nuk i publikon të dhënat dhe nuk i dorëzon në ENTSO-E në përputhje me detyrimet që i ka marrë përsipër me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare (neni 82, paragrafi (7))“.

Në paragrafin (3), në fjalinë hyrëse fjalët „ nga 5000 euro“ zëvendësohen me fjalët: „nga 3 000 euro deri 5 000 euro“, ndërsa pika 5) ndryshohet dhe bëhet:

“nuk e përgatit, harmonizoi me Ministrinë ose publikoi në ueb faqen e vet planin për zhvillimin e sistemit për transmetimin e energjisë elektrike, të aprovuar paraprakisht nga Komisioni Rregullator i Energjetikës i Energjetikës (neni 83, paragrafi (1)).”

Në paragrafin (4) në fjalinë hyrëse fjalët „nga 3000 euro“ zëvendësohen me fjalët „nga 2000 euro deri 3000 euro“.

Paragrafi (5) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorin e sistemit për transmetimin e energjisë elektrike, gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (3) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorin e sistemit për transmetimin e energjisë elektrike dhe gjobë në vlerë prej 300 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (4), personit përgjegjës në operatorin e sistemit për transmetimin e energjisë elektrike.“.

#### Neni 79

Në nenin 221 në paragrafin (1) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë operator në tregun e energjisë elektrike do t'i shqiptojë gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm ose gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“ .

Në paragrafin (2) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë operator në tregun e organizuar të energjisë elektrike do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm ose gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Në paragrafin (3) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë operator në tregun e energjisë elektrike do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm ose gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Në paragrafin (4) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë operator në tregun e energjisë elektrike do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1 000 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm ose gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 2 000 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Paragrafi (5) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë во vlerë од 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorinetregut të energjisë elektrike, gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (3) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorinetregut të energjisë elektrike dhe gjobë në vlerë prej 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (4) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorinetregut të energjisë elektrike.“.

Pas paragrafit (5) shtohet paragrafi ri (6) siç vijon:

„(6) Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (2) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorin e tregut të organizuar të energjisë elektrike.“.

#### Neni 80

Në nenin 222, në paragrafi (1), fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë deri 10% të të ardhurave të përgjithshme të personit juridik të realizuara në vitin paraprak fiskal në veprimtarinë energjetike për ushtrimin e të cilës ka marrë licencë nga Komisioni Rregullator i Energjetikës do t'i shqiptohet për kundërvajtje operatorit të sistemit për shpërndarje e energjisë elektrike nëse:“.

Në paragrafin (1) shtohet pika e re 1) siç vijon:

„1) stabilimentin për magazinimin e energjisë elektrike e shfrytëzon për sigurimin e shërbimeve për balancimin ose menaxhimin e ngulftajeve (neni 70-a paragrafi (2)).“

Pikat (1), (2), (3), (4), (5) dhe (6) bëhen pika (2), (3), (4), (5), (6) dhe (7).

Në paragrafin (2) në fjalinë hyrëse fjalët „nga 10 000 euro“ zëvendësohen me fjalët: „nga 7 000 euro deri 10 000 euro“.

Paragrafi (3) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje operatorit të sistemit për shpërndarjen e energjisë elektrike nëse nuk e përgatitë, harmonizon me Ministrinë dhe publikon në ueb faqen e vet planin për zhvillimin e sistemit për shpërndarjen e energjisë elektrike, të aprovuar paraprakisht nga Komisioni Rregullator i Energjetik (neni 94, paragrafi (2)).„

Në paragrafin (4), në fjalinë hyrëse fjalët: „nga 3 000 euro“ zëvendësohen me fjalët: „nga 1 000 euro deri 3 000 euro“.

Paragrafi (5) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorine sistemit për shpërndarjen e energjisë elektrike, gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (3) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorin e sistemit për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe gjobë në vlerë prej 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit(4) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorin e sistemit për shpërndarjen e energjisë elektrike“.

#### Neni 81

Në nenin 223, në paragrafin (1) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë furnizuese me energji elektrike do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 700 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si mikro tregtar, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 7000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtari madh, nëse:“

Pas pikës 3) shtohet pika e re 4) siç vijon:

„4) nuk mundësoi ndryshim të furnizuesit (neni 100, paragrafi (5), pika 6))“

Në paragrafin (2) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë furnizuese me energji elektrike do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si mikro tregtar, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 500 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1 500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtari madh, nëse:“

Pas pikës 6) shtohen tri pikë të reja 7) 8) dhe 9) siç vijon:

„7) nuk siguron besueshmëri të të dhënave nga kontrata e lidhur ose nuk i realizon sasitë e energjisë elektrike që i ka furnizuar për shkak të përmbushjes së detyrimeve nga kontrata (neni 100, paragrafi (6)),

8) nuk ka lidhur kontratë për furnizim me energji elektrike dhe dorëzimin e tepricës së së energjisë së prodhuar elektrike në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me kërkesë të konsumatorit-prodhues (neni 194-a, paragrafi (2)) dhe

9) nuk mban evidencë për kontratat e lidhura dhe/ose nuk dorëzon të dhëna për kontratat e lidhura (neni 194-a, paragrafi (2)).

Paragrafi (3) fshihet.

Paragrafi (4) bëhet paragrafi (3) dhe në të thuhet:

„(3) Gjobë në vlerë deri 10% të të ardhurave të përgjithshme të personit juridik të realizuara në vitin paraprak fiskal në veprimtarinë energjetike për ushtrimin e të cilës ka marrë licencë nga Komisioni Rregullator i Energjetikës do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë furnizues universal të energjisë elektrike nëse:“.

1) nuk i formon çmimet e shitjes për energji elektrike me zbatimin e sistemit tarifor (neni 29, paragrafi (5)),

2) nuk siguron furnizim dhe mbrojtje të konsumatorëve në rajonet e largëta (neni 101, paragrafi (1), pika 1)),

3) nuk siguron mbrojtje të konsumatorëve të rrezikuar (neni 101, paragrafi (1) ,pikë 2)),

4) nuk i zbaton çmimet për energji elektrike për furnizimin e amvisërive dhe konsumatorëve të vegjël (neni 101, paragrafi (1), pika 3)),

5) nuk zbaton procedura për furnizimin e energjisë elektrike sipas kushteve të tregut me përzgjedhjen e ofertës më të favorshme, në përputhje me rregullat për furnizim me energji elektrike të miratuara nga Komisioni Rregullator i Energjetikës (neni 101, paragrafi (1), pika 6)) dhe

6) nuk siguron furnizim me energji elektrike të amvisërive ose konsumatorit të vogël të cilit i ka pushuar kontrata për furnizim (neni 102, paragrafi (2)).

Në paragrafin (5), i cili bëhet paragrafi (4) ,fjalja hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„(4) Shoqërisë furnizuese universal me energji elektrike do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 500 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 1 500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Paragrafi (6), i cili bëhet paragrafi (5), ndryshohet dhe bëhet:

„(5) Shoqërisë furnizuese me energji elektrike në rast të fundit do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 1 500 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 4000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse nuk i furnizon konsumatorët që janë bërë furnizues me energji elektrike në rastet e përmendura në nenin, 102 paragrafi (1)“.

Në paragrafin (7), i cili bëhet paragrafi (6), fjalja hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„(6) Shoqërisë furnizues me energji elektrike në rast të fundit do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 500 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 1 500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Në paragrafin (8), i cili bëhet paragrafi (7), fjalja hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„(7) Shoqërisë tregtar me energji elektrike në rast të fundit do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 700 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si mikro tregtar, gjobë për kundërvajtje në vlerën ga 1 500 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Pika 2) ndryshohet dhe bëhet:

„nuk siguroi besueshmëri të të dhënave nga kontrata e lidhur ose nuk i realizoi sasitë e energjisë elektrike që i ka furnizuar për shkak të përmbushjes së detyrimeve nga kontrata (neni 105, paragrafi (4)).“

Paragrafi (9), i cili bëhet paragrafi (8), ndryshohet dhe bëhet:

„(8) Shoqërisë tregtar me energji elektrike në rast të fundit do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si mikrotregtar, gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 500 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari

nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 1 500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë nga 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse nuk u mundëson qasje në të dhënat Komisionit Rregullator të Energjetikës, Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës dhe Sekretariatit të Bashkësisë Energjetike (neni 103 paragrafi (1))“.

Paragrafi (10), i cili bëhet paragrafi (9), ndryshohet dhe bëhet:

„(9) Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë furnizues me energji elektrike dhe gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (2) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë furnizues me energji elektrike“.

Pas paragrafit (9) shtohen tre paragrafë të rinj (10), (11) dhe (12) siç vijon:

„(10) Gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (4) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë furnizuese universale me energji elektrike.

(11) Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (5) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë furnizuese me energji elektrike në rast të fundit dhe gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime sipas paragrafit (6) të këtij neni personit përgjegjës në shoqërinë furnizues me energji elektrike në rast të fundit.

(12) Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (7) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë tregtar me energji elektrike dhe gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (8) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë tregtare me energji elektrike“.

Paragrafët (11) dhe (12), të cilët bëhen paragrafë (13) dhe (14), ndryshohen dhe në to thuhet:

„(13) Shoqërisë furnizuese me energji elektrike ose shoqërisë tregtare me energji elektrike mund t’i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim të ushtrimit të veprimtarisë në kohëzgjatje deri gjashtë muaj për kundërvajtjet, sipas paragrafit (1), (2), (5) dhe (6) të këtij neni.

(14) Personit përgjegjës në shoqërinë furnizues me energji elektrike ose personit përgjegjës në shoqërinë tregtar me energji elektrike mund t’i shqiptohet sanksion kundërvajtës me ndalim të ushtrimit të veprimtarisë në kohëzgjatje deri gjashtë muaj për kundërvajtjet, sipas paragrafit (1), (2), (5) dhe (6) të këtij neni.“.

## Neni 82

Në nenin 224, në paragrafin (1), fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë deri 10% të të ardhurave të përgjithshme të personit juridik të realizuara në vitin paraprak fiskal në veprimtarinë energjetike për ushtrimin e të cilës ka marrë licencë nga Komisioni Rregullator i Energjetikës do t’i shqiptohet për kundërvajtje operatorit të sistemit për transmetimin e gazit natyror nëse:“

Në paragrafin (2) në fjalinë hyrëse fjalët „nga 10 000 euro“ zëvendësohen me fjalët: „nga 7 000 euro deri 10 000 euro“.

Në paragrafin (2), pika 5), fshihen fjalët: „dhe grupe balancimi“.

Në paragrafin (3) në fjalinë hyrëse fjalët „nga 5 000 euro“ zëvendësohen me fjalët „nga 3 000 euro deri 5 000 euro“.

Në paragrafin (3), pika 1), në kllapën numri „17“ zëvendësohet me numrin „6“.

Në paragrafin (4) në fjalinë hyrëse fjalët „nga 3 000 euro“ zëvendësohen me fjalët: „nga 2 000 euro deri 3 000 euro“.

Paragrafi (5) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorin e sistemit për transmetimin e gazit natyror, gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (3) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorin e sistemit për transmetimin e gazit natyror dhe gjobë në vlerë prej 300 euro në kundërvlerë denari t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (4) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorin e sistemit për transmetimin e gazit natyror.“

#### Neni 83

Në nenin 225, paragrafi (1), fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë operatori tregut të gazit natyror do t’i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm ose gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Në paragrafin (2) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë operatori tregut të gazit natyror do t’i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm ose gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Në paragrafin (3) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë operatori tregut të gazit natyror do t’i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm ose gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Paragrafi (4) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorin e tregut të gazit natyror, gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (2) të këtij neni, të personit përgjegjës në operatorin e tregut të gazit natyror dhe gjobë në vlerë 300 euro në kundërvlerë denari t’i shqiptohet për kundërvajtje për veprime, sipas paragrafit (3) të këtij neni, të personit përgjegjës në operatorin e tregut të gazit natyror.“.

#### Neni 84

Në nenin 226, në paragrafin (1), fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë deri 10% të të ardhurave të përgjithshme të personit juridik të realizuara në vitin paraprak fiskal në veprimtarinë energjetike për ushtrimin e të cilës ka marrë licencë nga Komisioni Rregullator i Energjetikës do t’i shqiptohet për kundërvajtje operatorit të sistemit për transmetimin e gazit natyror nëse:“.

Në paragrafin (2), fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë operatorit të sistemit për shpërndarjen e gazit natyror do t’i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1500 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Në paragrafin (3) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë operatorë sistemit për shpërndarjen e gazit natyror do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 500 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse nuk përpilon dhe publikon në ueb faqen evet plan për zhvillimin e sistemit për shpërndarjen e gazit natyror, paraprakisht të aprovuar nga Komisioni Rregullator i Energjetikës (Neni 130, paragrafi (2)).“.

Në paragrafin (4) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë operatorë sistemit për shpërndarjen e gazit natyror do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1 000 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 2 000 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Paragrafi (5) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni personit përgjegjës në operatorin e sistemit për shpërndarjen e gazit natyror, gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (3) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorin e sistemit për shpërndarjen e gazit natyror dhe gjobë në vlerë prej 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (4) të këtij neni, personit përgjegjës në operatorin e sistemit për shpërndarjen e gazit natyror.“.

#### Neni 85

Në nenin 227, në paragrafin (1), fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë furnizuese me gaz natyror do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 700 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si mikrotregtar, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1 500 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“ .

Në paragrafin (2) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë furnizuese me gaz natyror do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si mikrotregtar, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej prej 500 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Në paragrafin (3) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë furnizuese me gaz natyror me detyrim për shërbim publik do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1 500 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Pika 1) ndryshohet dhe bëhet:

„nuk i formon çmimet e shitjes për gaz natyror, me zbatimin e sistemit tarifor, sipas nenit 29, paragrafi (3), (neni 29, paragrafi (5))“.



Në paragrafin (4) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë furnizues me gaz natyror me detyrim për shërbim publik do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 500 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Paragrafi (5) ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë furnizues me gaz natyror në rastin e fundit do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1 500 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse nuk i furnizon konsumatorët të cilët kanë mbetur pa furnizues të gazit në rastet e përmendura në nenin 138, paragrafi (1).“.

Paragrafi (6) ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë furnizues me gaz natyror në rastin e fundit do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 500 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse nuk u mundëson qasje në të dhënat Komisionit Rregullator të Energjetikës, Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës dhe Sekretariatit të Bashkësisë Energjetike në përputhje me nenin 136, paragrafi (5), lidhur me nenin 138 paragrafi (12).“.

Në paragrafin (7) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë tregtare me gaz natyror do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 700 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si mikrotregtar, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1 500 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:“.

Paragrafi (8) ndryshohet dhe bëhet:

„Shoqërisë tregtare me gaz natyror do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si mikro tregtar, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 500 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse nuk u mundëson qasje në të dhënat Komisionit Rregullator të Energjetikës, Komisionit të Mbrojtjes së Konkurrencës dhe Sekretariatit të Bashkësisë Energjetike (neni 141, paragrafi (5)).“.

Paragrafi (9) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni personit përgjegjës në shoqërinë furnizues me gaz natyror dhe gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (2) personit përgjegjës në shoqërinë furnizues me gaz natyror.“.

Pas paragrafit (9) shtohen tre paragrafë të rinj (10), (11) dhe (12) siç vijon:

„(10) Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (4) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë furnizues me gaz natyror me detyrim për shërbim publik dhe gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (3) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë furnizues me gaz natyror me detyrim për shërbim publik.“.

„(11) Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (5) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë furnizues me gaz natyror në rast të fundit dhe gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (6) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë furnizues me gaz natyror në rast të fundit.

(12) Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (7) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë tregtar me gaz natyror dhe gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (8) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë tregtar me gaz natyror.“

Paragrafët (10) dhe (11), të cilët bëhen paragrafë (13) dhe (14), ndryshohen dhe në to thuhet:

„(13) Shoqërisë furnizues me gaz natyror ose shoqërisë tregtar me gaz natyror mund t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje ndalim të ushtrimit të veprimtarisë në kohëzgjatje deri gjashtë muaj për kundërvajtjet, sipas paragrafëve (1), (2), (7) dhe (8) të këtij neni.

(14) Personit përgjegjës në shoqërinë furnizues me gaz natyror ose personit përgjegjës në shoqërinë tregtar me gaz natyror mund t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje ndalim të ushtrimit të veprimtarisë në kohëzgjatje deri gjashtë muaj për kundërvajtjet, sipas paragrafëve (1), (2), (7) dhe (8) të këtij neni.“

#### Neni 86

Në nenin 228, në paragrafin (1), fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 700 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si mikro tregtar, gjobë në vlerë prej 1 500 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë në vlerë prej 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i madh, që ushtron veprimtari“.

Pas pikës 3) shtohen dy pika të reja 4) dhe 5) siç vijon:

„4) transporti i naftës së papërpunuar nëpërmjet naftësjellësit, respektivisht transporti i derivateve të naftës nëpërmjet produktësjellësit nuk u mundësoi qasje shfrytëzuesve të naftësjellësit, respektivisht produktësjellësi për shkak të transportit të naftës së papërpunuar, respektivisht derivateve të naftës, nëse janë përmbushur kushtet teknike për qasjen e palës së tretë (neni 145-a, paragrafi (1));

5) transporti i naftës së papërpunuar nëpërmjet naftësjellësit, respektivisht transporti i derivateve të naftës nëpërmjet produktësjellësit nuk siguroi besueshmëri të të dhënave afariste nga shfrytëzuesit (neni 145-a, paragrafi (3)).“

Pika 4) bëhet pika 6).

Në paragrafin (2) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si mikro tregtar, gjobë në vlerë prej 500 euro deri 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë në vlerë prej 1500 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i madh, që ushtron veprimtari“.

Paragrafi (3) ndryshohet dhe bëhet:

„Gjobë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (5) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë dhe gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (6) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqërinë“.

Paragrafi (4) ndryshon dhe bëhet:

„Për kundërvajtje, sipas paragrafit (1) të këtij neni, shoqërisë mund t'i shqiptohet ndalim për ushtrimin e veprimtarisë deri 30 ditë“.

Paragrafi (5) ndryshon dhe bëhet:

„Për kundërvajtje, sipas paragrafit (1) dhe paragrafi (2), këtij personit përgjegjës në shoqërinë mund t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e veprimtarisë në kohëzgjatje deri 30 ditë“.

## Neni 87

Neni 229 ndryshohet dhe bëhet:

(1) Shoqërisë prodhuese të energjisë termike do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 100 euro deri 300 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si mikro tregtar, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtari vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1 000 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 2 000 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse nuk u dorëzon raporte vjetore Komisionit Rregullator të Energjetikë dhe kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes lokale lidhur me pajisjen, objektet, planet për mirëmbajtje, si dhe kapacitetin e planifikuar (neni 152, paragrafi (3)).

(2) Shoqërisë prodhues i rregulluar i energjisë termike do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje me vlerë prej 100 euro deri 300 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si mikrotregtar, gjobë për kundërvajtje me vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje me vlerë prej 1 000 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë për kundërvajtje me vlerë prej 2 000 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse gjatë sezonit të ngrohjes nuk ka siguruar rezerva operative nga karburantë alternativë (neni 153 paragrafi (4)).

(3) Gjobë në vlerë prej 100 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë e klasifikuar si mikrotregtar, gjobë në vlerë prej 200 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë e klasifikuar si tregtari vogël ose i mesëm dhe gjobë në vlerë prej 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë e klasifikuar si tregtari madh, për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Personit përgjegjës në shoqërinë mund do t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje me ndalim të ushtrimit të detyrës në kohëzgjatje deri një vit“.

## Neni 88

Neni 230 ndryshohet dhe bëhet:

(1) Gjobë në vlerë deri 10% të të ardhurave të përgjithshme të personit juridik të realizuara në vitin paraprak fiskal në veprimtarinë energjetike për ushtrimin e të cilës ka marrë licencë nga Komisioni Rregullator i Energjetikës do t'i shqiptohet për kundërvajtje operatorit të sistemit për shpërndarjen e energjisë termike, nëse:“

1) nuk e mirëmban, zhvillon dhe, kur kjo shpaguhet në aspektin ekonomik, zgjeron sistemin e shpërndarjes së energjisë termike (neni 155, paragrafi (1), pika 2),

2) nuk i përfshin prodhuesit dhe konsumatorët e sistemit për shpërndarje të cilin e menaxhon, nuk u mundëson qasje palëve të treta për shfrytëzimin e sistemit për shpërndarje dhe nuk i zbaton çmimet dhe tarifatat e aprovuara paraprakisht nga Komisioni Rregullator i Energjetikës (neni 155, paragrafi (1), pika 3),

3) nuk i ndërmerr të gjitha masat e përcaktuara për siguri gjatë shfrytëzimit të sistemit për shpërndarjen e energjisë termike, si dhe masave për mbrojtjen e mjedisit jetësor (neni 155, paragrafi (1), pika 6),

4) nuk ushtron mbikëqyrje dhe testim të sistemit për shpërndarjen e energjisë termike (neni 155 (1), pika 10),

5) nuk e ndjekë gatishmërinë teknike dhe funksionale të objekteve për shpërndarjen e energjisë termike dhe në ueb faqen e vet nuk publikon informacione për gjendjen teknike të sistemit para dhe pas rekonstruksionit ose sanimit të kryer para avarisë së ndodhur (neni 155, paragrafi (1), pikë 11),

6) nuk blen energji termike nga prodhuesit e tjerë (neni 156, paragrafi (4)).

(2) Shoqërisë operatore të sistemit për shpërndarjen e energjisë termike do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1 500 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 4 000 euro deri 6 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 7 000 euro deri 10 000 euro në kundërvlerë denari nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:

1) nuk siguron energji termike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe shërbime sistimore nga prodhuesi i rregulluar (neni 155, paragrafi (1), pika 4),

2) nuk ushtron furnizimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve matëse në pikat dalëse nga stabilimentet prodhuese dhe nënstacionet termike në të cilat janë kyçur objektet e konsumatorëve dhe matje të energjisë termike që merret ose realizohet nga sistemi termik (neni 155, paragrafi (1), pika 5);

3) nuk e harmonizon punën e sistemit me prodhuesit për shkak të ushtrimit të papenguar të shpërndarjes së energjisë termike (neni 155, paragrafi (1), pika 9),

4) nuk përgatit parashikim afatgjatë të kërkesës së energjisë termike (neni 155, paragrafi (1), pika 12);

5) nuk e dorëzon në Komisionin Rregullator të Energjetikës dokumentacionin e plotë lidhur me përmbushjen e kontratave me prodhuesit dhe furnizuesit me energji termike, si dhe raportet financiare dhe raportet e reviduara financiare të përpiluara nga revizori i autorizuar, raportet për punën dhe të dhënat tjera (neni 156, paragrafi (6));

6) nuk i miraton dhe nuk i publikon në ueb faqen e vet rregullat e rrjetit për shpërndarjen e energjisë termike, paraprakisht të aprovuara nga Komisioni Rregullator i Energjetikës (neni 157, paragrafi (1)).

(3) Shoqërisë furnizuese me energji termike do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 300 euro deri 700 euro me kundërvlerën në denarë nëse është klasifikuar si mikro tregtar, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 500 euro deri 1 000 euro me kundërvlerën në denarë nëse është klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 1 500 euro deri 3 000 euro me kundërvlerën në denarë nëse është klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë për kundërvajtje në vlerë prej 3 000 euro deri 5 000 euro me kundërvlerën në denarë nëse është klasifikuar si tregtar i madh, nëse:

1) nuk i furnizon konsumatorët me të cilët ka lidhur kontratë për furnizim të sigurt, të vazhdueshëm dhe cilësor me energji termike (neni 158, paragrafi (1)),

2) nuk lidhë kontratë me operatorin e sistemit për shpërndarjen e energjisë termike për furnizimin e energjisë termike për nevojat e konsumatorëve (neni 158, paragrafi (2)),

3) nuk i dorëzon Komisionit Rregullator Energjetik, raporte vjetore për energjinë e shitur termike (neni 158, paragrafi (5)).

4) nuk i dorëzon Ministrisë dhe kryetarëve të njësive të vetëqeverisjes lokale në territorin e të cilave furnizuesi e ushtron veprimtarinë, raporte vjetore për energjinë e shitur termike (neni 158, paragrafi (6)).

(4) Gjohë në vlerë prej 1 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, të personit përgjegjës në shoqërinë dhe gjohë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (3), personit përgjegjës në shoqërinë“.

#### Neni 89

Në nenin 231, paragrafi (1), fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet:

„Gjohë në vlerë prej 100 euro deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si mikro tregtar, gjohë në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet si kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i vogël, gjohë në vlerë prej 1 000 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjohë në vlerë prej 2 000 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtari madh, nëse “pika 2) ndryshohet dhe bëhet:

„prodhuesi preferencial i cili shfrytëzon tarifë preferenciale nuk e njofton Komisioni Rregullator i Energjetikës për ndryshimet e ndodhura (neni 191, paragrafi (14)).”.

Pas pikës 2) shtohet pikë e re 3) siç vijon:

„3) prodhuesi preferencial i cili shfrytëzon tarifë preferenciale nuk ia shet energjinë e prodhuar elektrike vetm operatorit të tregut të energjisë elektrike (neni 192).“.

Pika 3) bëhet pika 4).

Paragrafi 2 ndryshohet dhe bëhet:

„Gjohë në vlerë prej 100 euro me kundërvlerë në euro do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë të klasifikuar si mikro tregtar, gjohë në vlerë prej 200 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë të klasifikuar si tregtari vogël ose i mesëm dhe gjohë në vlerë prej 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqërinë të klasifikuar si tregtari madh, për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (1) të këtij neni“.

#### Neni 90

Neni 232 ndryshohet dhe bëhet:

„Gjohë në vlerë prej 100 euro deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik shfrytëzues i sistemit të shpërndarjes elektronike, sistemit për shpërndarjen e gazit natyror ose sistemit për shpërndarjen e energjisë termike i klasifikuar si mikrotregtar, gjohë në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i vogël, gjohë në vlerë prej 1 000 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjohë në vlerë од 2 000 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë së klasifikuar si tregtar i madh, nëse nuk i mundëson personit të autorizuar të operatorit sistemit përkatës të drejtën e qasjes për shkak të ushtrimit të punëve sipas nenit 95 paragrafi (5), neni 131, paragrafi (4) dhe neni 159, paragrafi (3) të këtij ligji“.

(2) Gjohë në vlerë prej 200 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, shfrytëzues të sistemit të shpërndarjes së rrymës elektrike, sistem për shpërndarjen e gazit natyror ose sistemit për shpërndarjen e energjisë termike, nëse nuk i mundëson personit të autorizuar të operatorit sistemit përkatës të drejtën e qasjes për shkak të ushtrimit të punëve, sipas nenit 95 paragrafi (5), neni 131, paragrafi (4) dhe neni 159, paragrafi (3), të këtij ligji.

(3) Gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit individ shfrytëzues të sistemit energjetik nëse vepron në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në nenin 195, paragrafi (1), të këtij ligji.

(4) Gjobë në vlerë prej 100 euro deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik të klasifikuar si mikrotregtar, gjobë në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik të klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë në vlerë prej 1 000 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik të klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë në vlerë prej 2 000 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik të klasifikuar si tregtar i madh, nëse vepron në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në nenin 195, paragrafi (1) të këtij ligji.

(5) Gjobë në vlerë prej 200 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik shfrytëzues të sistemit energjetik nëse vepron në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në nenin 195, paragrafi (1) të këtij ligji.

(6) Gjobë në vlerë prej 100 euro deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë ushtrues të veprimtarisë energjetike të klasifikuar si mikro tregtar, gjobë në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë ushtrues të veprimtarisë energjetike të klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë në vlerë prej 1 000 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë ushtrues të veprimtarisë energjetike të klasifikuar si tregtari mesëm dhe gjobë në vlerë prej 2 000 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë ushtrues të veprimtarisë energjetike të klasifikuar si tregtar i madh, nëse i ka keqpërdorur fshehtësitë dhe informacionet afariste që i ka marrë gjatë ushtrimit të veprimtarisë për shkak të përvetësimit të dobisë afariste, si dhe për shkak të ndërmarrjes së veprimeve diskriminator në favor të personave të tretë (neni 202, paragrafi (2)).

(7) Gjobë në vlerë prej 100 euro deri 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik të klasifikuar si mikro tregtar, gjobë në vlerë prej 300 euro deri 700 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit fizik të klasifikuar si tregtar i vogël, gjobë në vlerë prej 1 000 euro deri 2 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit të klasifikuar si tregtar i mesëm dhe gjobë në vlerë prej 2 000 euro deri 3 000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik të klasifikuar si tregtari madh:

1) nëse nuk e regjistron elektrocentralen në regjistrin e elektrocentraleve që prodhojnë energji elektrike të prodhuar nga burimet e rinovuara të energjisë (neni 185 –a);

2) që ndërton ose realizon punë të tjera, mbjellë bimë dhe drunjtë në truall nën, mbi dhe pranë objekteve energjetike, pajisjeve dhe stabilimenteve me të cilat prishte procesi i prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë ose rrezikohet siguria e njerëzve dhe pasurisë, përveçse në rastet e përcaktuara me këtë ligj (neni 203, paragrafi (1)) dhe

3) pronar, respektivisht shfrytëzuesi i truallit nëse nuk lejon kalimin nëpërmjet atij trulli për ushtrimin e matjes, regjistrimit, projektimit dhe realizimit të punëve në mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e objekteve energjetike, si dhe ushtrimin e mbikëqyrjes inspektuese të objekteve që janë vendosur në atë truall (neni 204, paragrafi (1)).

(8) Gjobë në vlerë prej 200 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit përgjegjës në shoqëri.

(9) Gjobë në vlerë prej 300 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje për veprimet, sipas paragrafëve (1), (3), (4), (6) dhe (7) të këtij neni, edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(10) Gjobë në vlerë prej 400 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik për veprimet, sipas paragrafit (7) të këtij neni.

#### Neni 91

(1) Urdhëresën, sipas nenit 6 të këtij ligji, me të cilin ndryshohet neni 15, Qeveria e miraton në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Rregulloret, sipas nenit 7 paragrafi (4) të këtij ligji, me të cilin ndryshohet neni 24, paragrafi (1), pika 1), nënpika 22, Komisioni Rregullator i Energjetikës i miraton në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Rregullorja, sipas nenit 8 të këtij ligji, me të cilin ndryshohet neni 25, paragrafi (3), Komisioni Rregullator i Energjetikës e miraton në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(4) Sistemet tarifore, sipas nenit 10 të këtij ligji, me të cilin ndryshohet neni 29, paragrafi 3, Komisioni Rregullator i Energjetikës i miraton në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(5) Rregullat, sipas nenit 11 të këtij ligji, me të cilin shtohet neni i ri 30-a, Komisioni Rregullator të Energjetikës i miraton në afat prej gjashtë muajsh nga dita e e hyrjes në fuqi të këtij ligji

(6) Rregullat, sipas nenit 31 të këtij ligji, me të cilin në nenin 84 shtohet paragrafi i ri (4), Komisioni Rregullator i Energjetikës i miraton në afat prej gjashtë muajsh nga dita e e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(7) Rregullat, sipas nenit 32 të këtij ligji, me të cilin shtohet neni i ri 85-a, operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike e miraton në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

8) Rregullorja, sipas nenit 52 të këtij ligji, me të cilin shtohet neni i ri 172-a, ministri e miraton në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(9) Listën tarifore, sipas nenit 53 të këtij ligji, me të cilin në nenin 181 shtohet paragrafi i ri (9), ministri e miraton në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(10) Listën tarifore, sipas nenit 54 të këtij ligji, me të cilin ndryshohet neni 182 paragrafi (4), operatori i tregut të energjisë elektrike e miraton në afat prej gjashtë muajsh nga dita e e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(11) Urdhëresën, sipas nenit 54 të këtij ligji, me të cilin në nenin 182 shtohet paragrafi i ri (7), Qeveria e miraton në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(12) Rregulloret, sipas nenit 54 të këtij ligji me të cilin në nenin 182 shtohet paragrafi i ri (8), operatorii i tregut të energjisë elektrike i miraton në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(13) Rregulloren, sipas nenit 66 të këtij ligji, me të cilin në nenin 199 shtohet paragrafi i ri (12), ministri e miraton në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(14) Rregulloren, sipas nenit 68 e këtij ligji, me të cilin shtohet neni i ri 2008, Komisioni Rregullator i Energjetikës e miraton në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 92

(1) Regjistri i garancive për origjinën e energjisë elektrike të burimeve të ripërtërishme të energjisë, arkivi dhe dokumentacioni tjetër i lidhur me garancitë për prejardhje të cilat i ka në dispozicion Agjencia e Energjetikës, në afat prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji barten te operatori i tregut të energjisë elektrike.

(2) Procedurat për lëshim, bartje, shfuqizim ose anulimin e garancive për origjinë, si dhe për njohjen e garancive për origjinë të lëshuara në shtete të tjera, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë në përputhje me Ligjin e Energjetikës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.96/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.96/19).

#### Neni 93

(1) Anëtarëve të Komisionit për ankesa dhe zëvendësve të tyre të emëruar para hyrjes në fuqi të Ligji për energjetikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 96/18 dhe 96/19) pushojnë së ushtruari funksionin 30 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Procedurat e filluara para Komisionit për ankesa, sipas paragrafit (1) të këtij neni, në përputhje me Ligjin e Energjetikës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 16/11, 136/11, 79/13, 164/13, 41/14, 151/14, 33/15, 192/15, 215/15, 6/16, 53/16 dhe 189/16) vazhdon t'i udhëheqë Komisioni Rregullator i Energjetikës sipas ligjit që ka qenë në fuqi në ditën e nisjes së procedurës.

#### Neni 94

Dispozitat, sipas nenit 6 të këtij ligji, me të cilin ndryshohet neni 15, do të fillojnë të zbatohen nga 1 korrikut i vitit 2023.

#### Neni 95

Dispozitat, sipas nenit 52 të këtij ligji, me të cilin shtohet neni i ri 172-b, do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari i vitit 2023.

#### Neni 96

Dispozitat e nenit 2 të këtij ligji, me të cilat ndryshohet neni 3, neni 7 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 24, neni 8 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 25, neni 9 të këtij ligji me të cilin shtohet neni i ri 25-a, neni 24 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 67, neni 25 të këtij ligji me të cilin shtohet neni i ri 67-a, neni 32 të këtij ligji me të cilin shtohet neni i ri 85-a, neni 67 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 206, neni 68 të këtij ligji me të cilin shtohet neni i ri 208-a, neni 76 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 218 dhe neni 78 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 220, do të shfuqizohet në ditën e aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian.

#### Neni 97

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë pas shpalljes në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.